

**VLERËSIMI MJEDISOR
PËR**

**NDËRTIMIN E NJË SHKOLLE TË RE 9-VJEÇARE NË
PASKUQAN
NË KUADRIN E
PROJEKTIT CILËSIA DHE BARAZIA NË ARSIM (EEE-P)**

Tabela e përmbajtjes

1	HYRJE.....	5
2	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT.....	5
2.1	Objektivat e Projektit.....	5
2.2	Prioritetet e Projektit.....	5
2.3	Investime madhore fizike.....	6
3	PËRSHKRIMI I SHKOLLËS 9-VJEÇARE TË PASKUQANIT.....	9
3.1	Shkolla dhe sheshi.....	9
3.2	Mjediset rrethuese të shkollës.....	11
3.3	Alternativat e sheshit.....	13
4	Kushtet bazë mjedisore.....	14
4.1	Mjedisi fizik.....	14
4.1.1	Gjeologjia.....	14
4.1.2	Hidrogjeologjia.....	14
4.1.3	Cilësia e ujit të pijshëm.....	15
4.1.4	Cilësia e lumit të Tiranës.....	16
4.1.5	Cilësia e ajrit dhe burimet e shkarkimeve në Ajër.....	17
4.1.6	Cilësia e dheut.....	17
4.1.7	Zhurmat.....	17
4.1.8	Meteorologjia.....	18
4.2	Mjedisi biologjik.....	18
4.3	Mjedisi social - kulturor.....	19
5	Legjislacioni dhe procedurat mbrojtëse të mjedisit.....	20
5.1	Procedura/shqyrtimi i nënprojektit nga banka botërore... ..	20
5.2	Legjislacioni mjedisor shqiptar.....	21
6	Ndikimet e mundshme mjedisore.....	21
6.1	Ndikimet mbi mjedis të lidhura me vetë vendndodhjen.....	22
6.2	Ndikimet mjedisore gjatë fazës së ndërtimit dhe masat zbutëse përkatëse.....	26
6.2.1	Ndotja e ajrit.....	26
6.2.2	Prodhimi i mbetjeve.....	26
6.2.3	Zhurmat.....	27
6.2.4	Ndotja e dheut dhe ujit.....	28

6.2.5	Zbulimet rastësore	28
6.3	NDIKIMET MJEDISORE GJATË FAZËS SË FUNKSIONIMIT.....	29
6.3.1	Prodhimi i mbetjeve	29
7	PLANI I ADMINISTRIMIT MJEDISOR	30
8	FORCIMI I CAPACITETIT INSTITUCIONAL.....	41
9	PJESËMARRJA E PUBLIKUT	43
10	SHTOJCAT.....	45
10.1	SHTOJCA 1 ROLET DHE PËRGJEGJËSITË E ORGANEVE SHTETËRORE NË LIDHJE ME MJEDISIN.....	46
10.2	SHTOJCA 2 ANALIZA E UJIT TË PIJSHËM.....	49
10.3	SHTOJCA 3, ANALIZA E DHEUT	53
10.4	SHTOJCA 4, CILËSIA E LUMIT TË TIRANËS	57

Figurat:

Figurë 1	Planimetria e përgjithshme e shkollës.....	9
Figura 2	Sheshi i shkollës së ardhshme (shkolla dhe palestra)	11
Figura 3	Sheshi i shkollës së ardhshme (fushat e lojës).....	11
Figura 4	Paskuqan, Shqipëri.....	13
Figura 5	Hartë satelitore e komunës Paskuqan brenda rrethit Tiranë	13
Figura 6	Vendi i propozuar i shkollës në Paskuqan.....	13
Figura 7	Imazhi i sheshit në Google Earth	13
Figura 8	Vala e përmbytjes	22
Figura 9	Pamja e brigjeve të lumit të Tiranës nga ura e Paskuqanit	23
Figura 10	Pamja nga bregu i djathtë drejt anës së majtë të lumit të Tiranës (largësia nga shkolla rreth 100 m)	23
Figura 11	Lumi i Tiranës siç është në afërsi të shkollës së ardhshme	25
Figura 12	Rruga e ardhshme në afërsi të shkollës	25

Tabelat:

Tabela 1	Lista paraprake e shkollave për zgjerim dhe ndërtim, deri në datën 15 Korrik 2008	7
Tabela 2	Mjediset e planifikuara brenda ndërtesës së shkollës së re.....	10
Tabela 3	Klasifikimi i lumit të Tiranës	16

Tabela 4 Përqëndrimet e baktereve koliforme në lumin e Tiranës	17
Tabela 5 Tabela e shqyrtimit mjedisor të nën-projekteve	20
Tabela 6 Masat Zbutëse Mjedisore dhe veprimet e kërkuara përpara Fazës së Ndërtimit	31
Tabela 7 Masat Zbutëse Mjedisore për fazën e Ndërtimit	32
Tabela 8 Masat Zbutëse Mjedisore për fazën e Funkcionimit	35
Tabela 9 Plani i Monitorimit Mjedisor	37
Tabela 10 Përgjegjësitë për mjedisin gjatë ndërtimit dhe funksionimit	43

1 HYRJJE

Ky dokument paraqet Vlerësimin Mjedisor për ndërtimin e një shkolle 9-vjeçare në Paskuqan, Tiranë. Shkolla do të financohet në kuadrin e Projektit për Cilësinë dhe Barazinë në Arsim.

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të vlerësojë sheshin e përzgjedhur, të identifikojë ndikimet e mundshme të projektit mbi mjedisin dhe të këshillojë mbi masat e lehtësimit mjedisor dhe planin e monitorimit. Ky dokument siguron pajtueshmërinë me legjislacionin shqiptar mbi VNM si dhe me politikat mbrojtëse të Bankës Botërore.

2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

2.1 OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

Projekti i propozuar EEE-P do të mbështesë Qeverinë në zbatimin e fazës së parë të Strategjisë Kombëtare të Arsimit në Shqipëri (SKA). Objektivi i EEE-P është të përmirësojë cilësinë e kushteve të të mësuarit për të gjithë nxënësit, dhe të rritë regjistrimin në arsimin e mesëm të përgjithshëm, veçanërisht për të varfrit. Synimet e ndërmjetme janë përmirësimi i udhëheqjes, administrimit dhe qeverisjes së sistemit arsimor, përdorimi i metodave të reja të mësimdhënies nga mësuesit dhe të një llojshmërie më të madhe të mjeteve ndihmëse në shkolla, përmirësimi i cilësisë së infrastrukturës së shkollës dhe efikasitetit të saj, dhe ndërmarrjes së hapave të parë për reformën e arsimit të lartë.

2.2 PRIORITETET E PROJEKTIT

Projekti zbatohet nëpërmjet katër fushave prioritare.

Prioriteti 1: forcimi i udhëheqjes, administrimit dhe qeverisjes së sistemit arsimor (10 milionë US\$)

Kjo fushë prioritare synon të forcojë aftësitë udhëheqëse dhe administruese, dhe të përmirësojë qeverisjen dhe përgjegjshmërinë e sistemit arsimor. Kjo përfshin veprimtaritë të lidhura me decentralizimin, forcimin e udhëheqjes, zhvillimin profesional të drejtorëve të shkollave, vendim-marrjen dhe menaxhimin e burimeve në nivel shkolle, rritjen e pjesëmarrjes së komuniteteve, futjen e sistemit të administrimit mbi bazën e performancës, dhe shfrytëzimin e plotë të Sistemit të Informacionit Drejtues të Arsimit (Education Management Information System – EMIS) për vendim-marrje. Ofrimi i decentralizuar i shërbimit do të pilotohet në 2-3 rajone përpara se të merret një vendim për planin mbi shtrirjen e përgjithshme të tij. Kjo pritet të formojë një themel institucional për të trajtuar fushat e tjera prioritare.

Prioriteti 2: përmirësimi i kushteve për mësimdhënien dhe të mësuarin, (26 milionë US\$)

Kjo fushë prioritare përqendrohet mbi përmirësimin e cilësisë së kushteve të mësimdhënies dhe të mësuarit në një mënyrë gjithëpërfshirëse. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet

mbështetjes së zhvillimit profesional të mësuesve për t'i aftësuar ata në përdorimin e metodave më efektive të mësimdhënies në klasat e tyre. Kjo do të trajtonte dhe çështjet e reformës së programeve mësimore, përfshirë zhvillimin e një kuadri kombëtar për kurrikulat, racionalizimin e lëndëve mësimore, integrimin dhe zhvillimin e teksteve shkollore. Për të zbatuar reformën e kurrikulave, do të përafrohen politikat dhe praktikrat e arsimit të mësuesve. Zhvillimi i vlerësimit, dhe vlerësimi i arsimit do të vazhdojnë nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të Qendrës Kombëtare të Vlerësimit dhe Provimeve, zhvillimi i një plani kombëtar për vlerësimin në arsim, dhe përmirësimi i transparencës dhe integritetit të sistemit të maturës shtetërore. Kjo fushë prioritare i mundëson mësuesve dhe nxënësve përdorimin e një game më të gjerë të mjeteve dhe metodave të duhura arsimore në procesin e mësimdhënies dhe të mësuarit.

Prioriteti 3: përmirësimi dhe racionalizimi i infrastrukturës arsimore, (32 milionë US\$)

Kjo fushë prioritare trajton investimet më efikase dhe (ri)alokimin në infrastrukturë fizike dhe burime njerëzore veçanërisht në nivelin e arsimit të mesëm. Kjo do të mbështeste MASH në marrjen e vendimeve mbi investimet në bazë të hartës së shkollave, e cila merr në konsideratë zhvillimin demografik në Shqipëri. Do të jepen laboratorë shkencorë dhe mjedise të ICT për shkollat e mesme të përgjithshme në përputhje me kurrikulën e re dhe trajnimin e mësuesve që do të mbështeten në fushën prioritare dy.

Prioriteti 4: përgatitja e fazës së reformës së arsimit të lartë (7 milionë US\$)

Kjo fushë prioritare përqendrohet në mbështetjen e fazave fillestare të reformës së arsimit të lartë. Ajo mbështet MASH dhe universitetet për të kryer një analizë të sistemit për të identifikuar dhe përcaktuar radhën e veprimtarive të reformës, të cilat përfshijnë forcimin e qeverisjes së universiteteve, rritjen e autonomisë financiare dhe përgjegjshmërisë të universiteteve, forcimin e mekanizmit të sigurimit të cilësisë, dhe promovimin e marrëveshjeve të partneritetit të universiteteve. Ajo gjithashtu synon të rrisë mundësitë për studentët duke mobilizuar financimet private dhe dhënien dhe përdorimin e burimeve publike në mënyrë më efikase.

2.3 INVESTIME MADHORE FIZIKE

Komponenti kryesor i investimeve fizike i projektit të propozuar është në *fushën Prioritare 3 – përmirësimi dhe racionalizimi i infrastrukturës arsimore, veçanërisht në arsimin e mesëm*. Vendi i këtyre investimeve do të përcaktohet në bazë të të dhënave të hartëzimit të shkollave, duke marrë në konsideratë zhvillimin demografik në Shqipëri dhe disponueshmërinë e tokës që është pronë shtetërore. Për shkak se EEE-P do të përdorë një qasje që përfshin të gjithë sektorin, shtrirja e vërtetë e investimeve fizike dhe vendndodhja e tyre to të qartësohen nëpërmjet Programit Vjetor të Reformës. Lista paraprake e nën-projekteve është dhënë në Tabelën 1. veprimtaritë do të konsistojnë në punë ndërtimore të vogla për rehabilitimin dhe rinovimin e objekteve ekzistuese shkollore, ndërtimin e zgjerimeve të ndërtesave brenda oborreve ekzistuese dhe ndërtimin e shkollave të reja mbi sheshe të përcaktuara rishtas. Do të jepen laboratore shkencore dhe mjedise ICT për shkollat e mesme të përgjithshme në përputhje me kurrikulën e re dhe trajnimin e mësuesve që do të mbështeten në fushën prioritare dy.

Tabela 1 Lista paraprase e shkollave për zgjerim dhe ndërtim, deri në datën 15 Korrik 2008


LISTA E SHKOLLAVE PËR ZGJERIM DHE NDËRTIM				
15 Korrik 2008				
Emri i Shkollës	Vendndodhja	Punimet e ndërtimit	Natyra e pronës	Dokumentat e kërkuara për Vlerësimin Mjedisor
Shkollë 9-vjeçare ZallMner, Kamëz, Tiranë	Kamez-Zall Mner	Zgjerim i shkollës në oborrin ekzistues	Pronë Publike	Lista e PAM
Shkolla 9-vjeçare Ibrahim Rugova, Kamza, Tirane	Kamez Center	Zgjerim i shkollës në oborrin ekzistues	Pronë Publike	Lista e PAM
Shkolla e mesme, Ballsh, Mallakaster	Ballsh, Mallakaster	Zgjerim i shkollës në oborrin ekzistues	Pronë Publike	Lista e PAM
Shkolla 9-vjeçare Beslidhja, Lezhë	Lezhe	Zgjerim i shkollës në oborrin ekzistues	Pronë Publike	Lista e PAM
Shkolla e mesme , Lezhe	Lezhe	Zgjerim i shkollës në oborrin ekzistues	Pronë Publike	Lista e PAM
Shkolla 9-vjeçare Krumë, Krumë	Krume, Has	Zgjerim i shkollës në oborrin ekzistues	Pronë Publike	Lista e PAM
Shkolla 9-vjeçare B.Curri, Durrës	Durres city	Zgjerim i shkollës në oborrin ekzistues	Pronë Publike	Lista e PAM
Shkolla e mesme Kilicë, Fier	Fier city	Zgjerim i shkollës në oborrin ekzistues	Pronë Publike	Lista e PAM
Shkolla 9-vjeçare Paskuqan, Paskuqan, Tiranë	Paskuqan	Ndërtim i shkollës së re mbi një shesh oborri të ri	Tokë komunale Në pritje të vendimit të gjykatës	VM me PAM
Shkollë 9-vjeçare Saranda, Saranda	Saranda	Ndërtim i shkollës së re mbi një shesh oborri të ri	Pronë Publike Në pritje të letrave të pronësisë dhe vendimit të gjykatës	VM me PAM
Shkollë e mesme , Shkoder	Shkoder	Ndërtim i shkollës së re mbi një shesh oborri të ri	Pronë Publike (ish institute shtetëror i pujeve) Në pritje të letrave të pronësisë dhe vendimit të gjykatës	VM me PAM

Shkollë e mesme, Vlora	Vlora city	Ndërtim i shkollës së re mbi një shesh oborri të ri	Pronë Publike Në pritje të letrave të pronësisë dhe vendimit të gjykatës	VM me PAM
Shkolla 9-vjeçare Qesarak, Dajt, Tirane	Dajt-Qesarake	Ndërtim i shkollës së re mbi një shesh oborri të ri	Tokë komunale Në pritje të letrave të pronësisë dhe vendimit të gjykatës	VM me PAM
Shkollë e mesme, Fushe Kruje, Kruje	Fushe-Kruje, Kruje	Ndërtim i shkollës së re mbi një shesh oborri të ri	Vendi nuk është identifikuar ende Në pritje të letrave të pronësisë dhe vendimit të gjykatës	VM me PAM
Peshkopi, Diber Shkollë e mesme, Peshkopi, Diber	Peshkopi, Diber	Ndërtim i shkollës së re mbi një shesh oborri të ri	Në pritje të shpronësimit. Në pritje të Planit të Shkurtuar të Zhvendosjes	VM me PAM
Shkollë 9-vjeçare, Bajram Curri, Tropoje	Bajram Curri, Tropoje	Ndërtim i shkollës së re mbi një shesh oborri të ri	Në pritje të shpronësimit. Në pritje të Planit të Shkurtuar të Zhvendosjes	VM me PAM
Shkolla 9-vjeçare, Kamëz- Bathore, Tiranë	Kamza- Bathore	Ndërtim i shkollës së re mbi një shesh oborri të ri	Në pritje të shpronësimit. Në pritje të Planit të Shkurtuar të Zhvendosjes	VM me PAM
Shkollë 9-vjeçare Bulcesh, Kamëz- Bulcesh, Tirane	Kamza-Bulcesh	Ndërtim i shkollës së re mbi një shesh oborri të ri	Në pritje të shpronësimit. Në pritje të Planit të Shkurtuar të Zhvendosjes	VM me PAM
Shkollë 9-vjeçare Shkoder	Mar-Lulaj	Ndërtim i shkollës së re mbi një shesh oborri të ri	Në pritje të shpronësimit. Prishje e pronës në 4 Qershor 2008. Në pritje të masave përkatëse të MASH.	VM me PAM

3 PËRSHKRIMI I SHKOLLËS 9-VJEÇARE TË PASKUQANIT

3.1 SHKOLLA DHE SHESHI

Projekti i shkollës së re do të bazohet mbi Planin e Përgjithshëm të përgatitur nga Autoritetet vendore. Shkolla do të ketë orientim jug-lindje, në mënyrë që klasat të kenë ndriçim dhe ngrohje natyrore. Kjo hapësirë shkolle do të përbëhet nga disa elementë: vetë shkolla, palestra dhe dy fusha loje. Planimetria e përgjithshme paraqitet në Figurën 1.



Figurë 1 Planimetria e përgjithshme e shkollës

Tabela e mëposhtme (tabela 2) paraqet mjediset e planifikuara brenda vetë shkollës dhe palestra. Janë përgatitur udhëzimet e përgjithshme të projektit të lidhura me madhësinë e llojeve individuale të mjediseve, komunikimin ndërmjet mjediseve, rrigëve dhe daljeve të emergjencës dhe aksesin e njerëzve me aftësi të kufizuara, vetitë elektrike dhe të ndriçimit, kërkesat e sigurisë, telefoninë dhe internetin, izolimin termik, ngrohjen, dhe peisazhin e jashtëm.

Tabela 2 Mjediset e planifikuara brenda ndërtesës së shkollës së re.

Zona	Përshkrimi	Numri i dhomave	Numri i nxënësve	Hapësira m ² për çdo nxënës	Sipërfaqja totale e dhomës	Sipërfaqja totale të të gjithë dhomave
Kërkesat për hapësirën e shkollave të mesme, bazuar në standartet dhe kurrikulën e shkollës.						
Zona e mësimit						
	Klasa të përgjithshme	24	30	1.5	45	1,080
	Laboratori i fizikës + aneks	1	30	2.5	75	75
	Laboratori i kimisë + aneks	1	30	2.5	75	75
	Laboratori i biologjisë + aneks	1	30	2.5	75	75
	Laboratory i kompjuterave	1	30	2.5	75	75
	Hapësirë shumë-funksionale	1	180	2.5	450	450
	Dhoma audio-vizuale	1	30	2.5	75	75
	Biblioteka	1	30	2.5	75	75
ZONA E DREJTIMIT TË SHKOLLËS						
	Drejtoria	1			25	25
	Sekretaria	1			16	16
	Zëvendës drejtoria	3			16	48
	Dhoma e mbledhjeve	1			100	100
	Dhoma e mësuesve (dhoma operative)	1	43	1.6	70	52
	Dhoma e mësuesve (dhoma e studimit)	1			30	30
	Arkiva	1			25	25
	Dentisti	1			35	35
	Mjeku	1			35	35
	Ndihma sociale	1			25	25
	Dhoma e rojes	1			10	10

Mjediset ndihmëse						
	Fast Food	1			50	50
	Shërbimi + Kuzhina	1			10	10
	Palestra e mjediset ndihmëse të saj.	1			618	618
	Magazine e shkollës	1			30	30
	Banjot e nxënësve	1		6.0	162	162
	Banjot për mësuesit dhe personat me aftësi të kufizuara	3			10	30
Mjediset e shërbimit						
	Depozitat e gazit	1			35	35
	Dhoma e kaldajës	1			60	60
	SIPËRFAQJA TOTALE M² SHKOLLA + PALESTRA					3,346

Hapësira e vendit është i përshtatshëm për këtë lloj strukture (figurat 2 dhe 3).



Figura 2 Sheshi i shkollës së ardhshme (shkolla dhe palestra)



Figura 3 Sheshi i shkollës së ardhshme (fushat e lojës)

3.2 MJEDISËT RRETHUESE TË SHKOLLËS

Shkolla është vendosur brenda kufijve të fshatit të Paskuqanit në rrethin e Tiranës. Figura 4 tregon pozicionin e Paskuqanit në Shqipëri, ndërsa figura 5 tregon një imazh satelitor të

zonës së Paskuqanit. Paskuqani është një fshat, një zonë e dikurshme e bujqësisë së shkallës së vogël që ka përjetuar një shpërthim demografik në fund të viteve 90 kur popullata kryesisht nga Shqipëria e veriut u vendosën në zonë dhe prandaj zona karakterizohet nga një planifikim urban i varfër. Shkolla e propozuar do të vendoset mbi fusha që kanë mundësi të përmyten, të cilat do të mbrohen me anë të projekteve të tjera të përmendura në tekst (shih seksionin 6.1). Disa ndërtesa të tjera janë duke undërtuar në afërsi, siç janë një qendër shëndetësore, dhe pak shtëpi banimi.



Figura 4 Paskuqan, Shqipëri




Figura 5 Hartë satelitore e komunës Paskuqan brenda rrethit Tiranë



Figura 6 Vendi i propozuar i shkollës në Paskuqan



Figura 7 Imazhi i sheshit në Google Earth

3.3 ALTERNATIVAT E SHESHIT

Komuna e Paskuqanit është përpjekur të gjejë një shesh që ishte pronësi e komunës për të shmangur kostot e blerjes së tokës dhe një zhvendosjeje të mundshme. Nuk janë parë

alternative të tjera. Megjithatë, nëse VNM tregon që ky vend nuk është i parnueshëm, Komuna do të shqyrtojë mundësi të tjera për blerjen e tokës private.

4 KUSHTET BAZË MJEDISORE

4.1 MJEDISI FIZIK

4.1.1 Gjeologjia

Rajoni i Tiranës i përket zonës Neogjeniane dhe Kuaternare dhe është përfaqësuar mirë nga depozitat aluviale të lumit të Tiranës të cilat janë ndërthurur me depozita proluviale, këto të fundit të përfaqësuara nga materiale kokërrmadhe deri në rërat me madhësi të mesme ngjyrë grin ë kafe të cilat duken të jenë mjaft të trasha në strukturë. Duke vazhduar poshtë rrjedhës nga shtrati i lumit drejt brigjeve ato zvogëlohen në madhësi dhe mëtej ato përfshihen në përbërjen deluviale – eluviale shumë të qëndrueshme. Poshtë kësaj shtrese mund të hasen lehtësisht depozita neogjeniane të cilat përfaqësohen nga rëra dhe argjila gri në kafe me bazë të dobët të çimentuar për shkak të aktivitetit të agjentëve atmosferikë dhe lagështisë, ndërsa në një thellësi prej rreth 3-4 metra brenda nivelit fizik të dheut mund të hasen shtresa të forta argjile të ndërthurura me rëra karbonike me praninë më sporadike të gurëve të strallit/zhavorrit të cilat shkojnë 5-6 mm në gjatësi – të cilat veprojnë për të formuar bazën e kodrës së kuqe në të cilën ka lagështi të konsiderueshme, megjithëse të papërshkrueshme nga uji.

Në zonën e studimit mbi bazën e rajonizimit sizmik të Republikës së Shqipërisë, sheshi i ndërtimit është pjesë e zonës që karakterizohet nga aktivitetet sizmik të intensitetit të ulët në një shkallë të hapur 8 pikëshe Richter MSK-64. Çdo ndërtesë në zonë rekomandohet të përballojë lëkundje të një tërmeti deri në 8 pikë të shkallës Richter MSK-64.

4.1.2 Hidrogeologjia

Përsa i përket hidrologjisë, mund të thuhet që zona që studiohet nuk ka ujëra sipërfaqësore, përveç lumit të Tiranës që është një veçori e përhershme në zonë. Pjesa që i përket shtratit të lumit me gjerësi 15 metra dhe thellësi 2.3 metra është e ngopur me ujë dhe lagështirë (shkolla është rreth 90 metra larg nga shtrati i lumit). Lumi i Tiranës në pjesë e sipërme të rrjedhës së tij përbëhet nga tre degë që e ushqejnë: përroi i Mojsitit, a ii Selitës dhe Zall-Bastarit. Tre përrenjtë bashkohen për të formuar lumit e Shupalit. Në afërsi të 2.5 km nga qendra e komunës së Zall-Dajtit, lumi ndryshon emrin e tij dhe quhet Lumi i Tiranës dhe vazhdon poshtë me këtë emër derisa bashkohet me Lumin e Tërkuzës dhe formojnë lumin Gjole. Ujërat nëntokësore janë në nivel të ulët dhe varen shumë nga koha e stinës, të cilat rrjedhin nga pjerrësitë dhe përrenjtë ku janë të pranishme shtresat ranore dhe poroze. Kjo zonë është pjesë e silikateve argjilore morfo-strukture në zonën më të gjerë të zinxhirit kodrinor të ultësirës që shtrihet nga Bovilla drejt malit të Dajtit dhe më tej drejt lindjes duke lidhur Kamzën me fshatin e Babrusë. Kjo megastrukturë mori konturet e saj fillestare me konsolidime të mëtejshme drejt mesitë të erës *moicen tortoniane* e cila gradualisht përjetoi kushtet kontinentale gjatë gjithë akullnajave të *poliocenit* duke sjellë formimin e udhëve ujore dhe një relievi mjaft të diferencuar si dhe kullimeve të tjera

nëntokësore me reshje që lëviznin drejt përroit të Babroit. Megjithatë, vetë relievi i veçantë për zonën nën ndikimin në rritje të veprimtarisë njerëzore që ndërvepron me faktorët e tjerë gjeo-morfologjikë kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në ruajtjen e të gjithë veçorive gjeo-morfologjike që i përshtaten komunitetit që është vendosur në zonë.

Në zonë, siç e tregojnë studimet, nuk ka ujëra nëntokësore masive për tu përmendur. Të dhënat gjeologjike dhe hidrologjike të paraqitura këtu i detyrohen pjesërisht studimeve të detajuara siç është “gjeo-inxhinieria” nga Njësia e Kërkimit, Inxhinieria Gjeologjike dhe A.L.T.E.A & Geo Studio 2000 Ltd (Testimi Laboratorik për Materialet e Ndërtimit dhe Studimi Gjeoteknik).

Burimet ujore në komunën e Paskuqanit, siç dhe rasti i gjithë zonës së Tiranës, janë pothuajse të papërfillshme. Kjo i referohet si ujrave sipërfaqësore ashtu dhe atyre nëntokësore. Shkolla e planifikuar do të lidhet me ujësjellësin që vjen nga impianti i Bovillës, impiant që është gjithashtu burim i ujit të pijshëm për qytetin e Tiranës. Lumi i Tiranës rrjedh pranë vendit që po studiohet; largësia nga ndërtesa e ardhshme e shkollës vlerësohet të jetë 90 – 120 m. Gjithashtu nuk ka punime ujore madhore në proces për momentin, por në 2009/2010 punime të mëdha priten në lidhje me një projekt të financuar nga JAICA – një projekt i financuar nga Japonia i cili pritet të japë fondet për kanalizimet në të dy anët e lumit, trajtim së bashku me zbatimin e masave për menaxhimin e lumit (kontrolli i rrjedhës dhe përmbytjeve të mundshme) dhe përpjekjet e pastrimit duke u përpjekur në të njëjtën kohë për të minimizuar në mënyrë thelbësore praninë e ndotësve (kryesisht mbetje të depozituara në të dy brigjet e lumit). Përveç projektit të përmendur më sipër, do të ndërtohet një rrugë përgjatë brigjeve të lumit të Tiranës (shih seksionin 6.1).

Hetimet e kryera nga Instituti i Hidrometeorologjisë që shohin vlerësimet e nivelit maksimal të shirave përfunduan që në gjendjen e tanishme (pa zbatimin e masave shtesë mbrojtjeje ndaj përmbytjeve) nuk pritet të ketë përmbytje të shkaktuara nga stuhitë e shpejta apo përmbytjet e menjëhershme. Në bazë të nivelit maksimal të prurjes së ujit në të cilën koeficienti i bazës së lumit u morn ë $n=0035$ dhe pjerrësia e rrjedhës në $i=0012$, përlllogaritjet nxorën që niveli i prurjes prej $550\text{m}^3/\text{s}$ zë një sipërfaqe prej rreth 135m^2 , e cila nuk ka të ngjarë të jetë maksimale, dhe i përket rrezes prej 89.3 m, ndërsa ndërtesa e shkollës qëndron në 89.9 m. Kështu që sheshi ku do të ndërtohet shkolla qëndron në kuotën 0.6 mbi nivelin e ujit në lidhje me plotën 100 vjeçare. Masat mbrojtëse të përmbytjes do të përmirësohen në zbatim të projektit JAICA si dhe me ndërtimin e rrugës Babrru – Bregu i Lumit – Kthesa e Kamzes përgjatë brigjeve të Lumit të Tiranës (shih seksionin 6.1.).

4.1.3 Cilësia e ujit të pijshëm

Për qëllimin e projektit, Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Shëndetit Publik ka analizuar ujin e pijshëm nga impianti i Bovillës në 22 Maj 2009, me të cilin do të lidhet shkolla e ardhshme. Janë kryer analiza fisiko-kimike, mikrobiologjike dhe toksikologjike (metale, PAH dhe pesticide). Rezultatet tregojnë që uji është i përshtatshëm për pirje. Nuk janë gjetur baktere koliform apo steptokok, si dhe asnjë PAHs ose pesticide (rezultatet e analizës i janë bashkëngjitur këtij dokumenti).

4.1.4 Cilësia e lumit të Tiranës

Për qëllimin e ndërtimit të shkollës, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave ka informuar MASH mbi cilësinë e lumit të Tiranës, i cili tregon ndotje të madhe fekale si dhe nga sasia e mbetjeve që depozitohet mbi brigjet e lumit të Tiranës. Programi i monitorimit të ujrave sipërfaqësore në vitin 2008, i zbatuar nga Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve mori të dhëna mbi cilësinë e lumit të Tiranës përgjatë tre stacioneve të monitorimit: Ura e Brarit, Zona e Paskuqanit - 500 metra larg nga kolektori i ujrave të Siri Kodra – dhe ura e Kamzës.

Bazuar në rezultatet mesatare të analizës, (table 3) është kryer vlerësimi mbi cilësinë e ujit të lumit të Tiranës, duke i grupuar veti dhe parametra të rëndësishme sipas klasifikimit të UNESCO,

Tabela 3 Klasifikimi i lumit të Tiranës

Stacionet	Klasa P, totali	Klasa N03	Klasa NB05	Klasa NKO	Klasa NH4	Klasa 02
T1: Ura e Brarit	IV (tejkalon)	I	II	II	I	II
T2: pas kolektorit të ujrave në Siri Kodra	IV (tejkalon)	I	V (tejkalon)	V (tejkalon)	IV	III
T3: Ura e Kamzës	V (tejkalon)	I	V (tejkalon)	V (tejkalon)	V (tejkalon)	III

Nga tabela e mësipërme është e mundur të dallohet që tek Ura e Brarit, ujrata e lumit klasifikohen që i përkasin cilësisë së dytë (nivel i mjaftueshëm) me përjashtim të përmbajtjes së fosforit e cila përgjithësisht një lidhje me pjesën tjetër të lumenjve shqiptarë.

Rezultatet e analizës së nitrarit tregojnë vlera të ulëta përgjatë gjithë gjatësisë së lumit në shqyrtim. Një përqëndrim i ulët i nitrateve do të haset dhe në stacionet e tjera siç do të shohim më poshtë.

Duke lëvizur nga lumi i Brarit (stacioni 1) drejt urës së Kamzës (stacioni 3), lumi i Tiranës është pika marrëse e shkarkimeve të mbetjeve të lëngshme të popullatës që është vendosur përgjatë brigjeve të lumit në dhjetëvjeçarin e fundit si dhe të shkarkimeve urbane që vijnë nga kolektorët e shkarkimit të qytetit në rrugët “Siri Kodra” dhe “5 Maji” street. Këto shkarkime mund të konsiderohen si fajtorët kryesorë për vlerat e larta të fosforit (përveç përqëndrimeve tashmë të larta të përqëndrimit të fosforit) i cili i atribuohet kryesisht përdorimit të detergjentëve me përmbajtje të lartë fosfori nga ana e popullatës si dhe përmbajtjet e lartë e lëndës organike (ujrat urbane) e cila shprehet në vlerat e larta të NBO, NKO dhe NH4.

Siç tregohet në tabelën e klasifikimit, përveç stacionit të parë të monitorimit, ura e Brarit, dy stacionet e tjera shfaqin një prani alarmuese të lartë të lëndës organike në ujrata e lumit të Tiranës.

Të sipërpërmendurat shkaktojnë një gjendje serioze të procesit të *eutrofikimit* dhe rënies së oksigjenit në ujë. Gjendja mund të lidhet gjithashtu me mbetjet e lëngshme urbane, të cilat shkarkohen të patrajtuara dhe/ose mbetjeve të ngurta të shkarkuara në brigjet e lumit. Masat drejt përmirësimit të gjendjes do të duhet të jenë të rrepta dhe të shumëfishta në natyrë.

Duke krahasuar dhe ballafaquar treguesit bakterologjikë të analizës, dhe veçanërisht *feces coliform*, përkundrejt normave detyruese të vendosura nga Direktiva e BE mbi ujrat larëse (nga viti 1976), në të tre stacionet mbi lumin e Tiranës të monitoruara, vlera qëndron shumë më lart se në normat e lejueshme.

Tabela 4 Përqëndrimet e bakteve koliforme në lumin e Tiranës

Stacionet	Coliform (mesatare)	feces	Klasifikimi
T1: Ura e Brarit	1.4×10^5		Tejkalim norme
T2: Pas kolektorit të Siri Kodrës	9.6×10^6		Tejkalim norme
T3: Ura e Kamzës	3.1×10^7		Tejkalim norme

Ky vlerësim kërkon një ndalim të menjëhershëm të përdorimit të ujit të lumit të Tiranës për qëllime larjeje apo veprimtari të tjera shlodhëse, të paktën përgjatë gjatësisë së lumit në studim.

4.1.5 Cilësia e Ajrit dhe Burimet e Shkarkimeve në Ajër

Nga të gjithë shenjat, nuk ka matje të cilësisë ajrit në afërsi të sheshit. Megjithatë, nuk ka termocentral ose incinerator në afërsi dhe as industri të rëndë që mund të shkaktojë ndotje të madhe të ajrit. Burimi më i afërt i ndotjes është një fabrikë e prodhimit të tullave që është rreth 500 metra larg, në pjesën perëndimore të sheshit të ndërtimit, përtej lumit. Megjithatë, kjo fabrikë është jashtë pune dhe strukturat përdoren vetëm për magazinimin e materialeve të ndërtimit. trafiku është i vetmi kontribues i madh i ndotjes së ajrit.

4.1.6 Cilësia e dheut

Për qëllimin e projektit, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Qendra për Fizikën Bërthamore mori 5 kampione dheu në sheshin ku do të ngrihet shkolla e ardhshme dhe i analizoi ato për metalet e rënda dhe iztopet radioaktive. Rezultatet tregojnë vlera më të larta të Cr, Mn dhe Ni, të cilat lidhen me karakteristikat gjeologjike të zonës (referenca Atlasi Gjeografik i Shqipërisë, me autorë A. Tashko, A. Mazreku, et al. 1997-1998). Dheu nuk u analizua për ndotje nga nafta / PAH sepse: a) nuk ka histori të veprimtarive ekonomike në vendin e propozuar ose në rrethina të cilat mund të tregojnë ndotje nga PAH / nafta; b) ekzaminimi bazë (shqisor) i kampioneve të dheut nuk tregoi një prani të këtyre ndotësve (shih shtojcën). Gjithashtu, përdorimi i mëparshëm i tokës nuk përfshinte veprimtari bujqësore; prandaj analiza për praninë e pesticideve nuk u krye.

Megjithatë, dheu në zonë (brigjet e lumit) është i ngarkuar me sasi të mëdha të mbetjeve të shkarkuara në brigjet e lumit, prandaj masa të veçanta janë paraqitur në këtë studim.

4.1.7 Zhurmat

Aktualisht nuk ka shkarkues të rëndësishëm zhurmash afër sheshit, dhe nuk ka asnjë trafik automjetesh, meqenëse sheshi është mjaft i larguar nga rruga kryesore e fshatit të Paskuqanit dhe ndodhet në një vend të qetë të komunës, e cila e siguron mjaft dhe sigurinë e nxënësve.

Për më tepër, aktualisht po ndërtohet një qendër mjekësore e specialiteteve pranë sheshit të ndërtimit.

Megjithatë, në procesin e planifikimit të rrugës Road Babru – Bregu i Lumit – Kthesa e Kamzes, një rrugë që do të ndërtohet përgjatë brigjeve të lumit, do të ketë impakte të rëndësishme mjedisore (ndotje ajri, zhurma) dhe të sigurisë (përshkruar në seksionin 6.1).

4.1.8 Meteorologjia

Temperatura

Regjimi i temperaturave është tipik Mesdhetar, i karakterizuar nga vera e nxehtë dhe dimri i ftohtë. Temperatura mesatare vjetore është 16 °C. Temperaturat absolute maksimale dhe minimale të vëzhguara janë përkatësisht 40 °C dhe – 6 °C.

Reshjet

Regjimi i reshjeve është gjithashtu tipik Mesdhetar. Vetëm 5-10% e reshjeve vjetore bie gjatë sezonit të thatë, dhe shumica e shiut bie në dimër. Reshjet mesatare vjetore për Tiranën janë 1,108 mm. Reshjet maksimale mujore të vëzhguara janë 211 mm.

Mesatarja e motit për Tiranën e madhe

Muaji	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj
Mesatarja e lartë °C (°F)	12 (54)	12 (54)	15 (59)	18 (64)	23 (73)	28 (82)	31 (88)	31 (88)	27 (81)	23 (73)	17 (63)	14 (57)
Mesatarja e ulët °C (°F)	2 (36)	2 (36)	5 (41)	8 (46)	12 (54)	16 (61)	17 (63)	17 (63)	14 (57)	10 (50)	8 (46)	5 (41)
Reshjet mm (inç)	135 (5.31)	152 (5.98)	128 (5.04)	117 (4.61)	122 (4.8)	86 (3.39)	32 (1.26)	32 (1.26)	60 (2.36)	105 (4.13)	211 (8.31)	173 (6.81)

4.2 MJEDISI BIOLOGJIK

Zona e Paskuqanit është e njohur për florën e saj të pasur. Megjithëse është një mjedis urban, ka shumë të ngjarë të gjesh pemë plepi të mbjella përgjatë gjatësisë më të madhe të lumit si dhe pemë të tjera të mbjella në pronat ngjitur. Këto pemë nuk shihen në vendin e

shkollës së ardhshme. Zona karakterizohet nga prania e bimësisë tjetër, kryesisht manaferra, një zonë që mund të klasifikohet lehtësisht si shkurnajë. Nga ana tjetër, fauna është karakterizuar nga amfibët (më së shumti brektosa dhe kërmij). Nuk ka aktualisht faunë të egër në zonë, përveç kafshëve shtëpiake që janë pronë e njerëzve në Paskuqan. Në pjesën më të madhe të zonës popullata e shpendëve është disi e konsiderueshme e përbërë nga një llojshmëri zogjsh nga harabelat tek pëllumbat. Megjithatë bimësia nuk është mjaft e dendur për të mbajtur më shumë lloje. Zona e shkollës së ardhshme nuk është në afërsi të ndonjë vendi natyror të mbrojtur dhe as nuk ka prani të llojeve të mbrojtura të bimëve.

4.3 MJEDISI SOCIAL – KULTUROR

Gjëja që të bën më shumë përshtypje është se Tirana është rritur shumë duke filluar nga viti 1990. Kështu e njëjta rritje në popullsi është shtrirë dhe në komunat ngjitur me Tiranën në dhjetëvjeçarët e fundit. Kjo ka marrë formën e shumë vendbanimeve informale. Komuna e Paskuqanit nuk ishte e imunizuar nga këto tendenca të zhvillimit të popullsisë.

Popullata rurale me qendrtën e saj në Babrru, gjatë periudhës 1989-1992 kishte rreth 5000 banorë, ndërsa nëse krahasohet me shifrat e regjistrimit të popullsisë në vitin 2008, numri është rritur në 41000 siç është regjistruar në Zyrat e Gjendjes Civile. Me shifra të vërteta, Paskuqani ka rreth 50 000 banorë, kjo vjen nga fakti që jo e gjithë popullata është regjistruar në Paskuqan (ata mbeten të regjistruar në zonat nga kanë ardhur). Ky fenomen është i zakonshëm për të gjithë vendbanimet informale në zonat e tjera rreth Tiranës.

Vetëm dhjetëvjeçari i fundit ka parë migrime të popullsisë që kanë qenë krejtësisht të pakontrolluara, kjo si rrjedhojë e lëvizjeve të mëdha nga zonat e largëta veriore drejt komunës. Ata vijnë nga zona të ndryshme të largëta duke përfshirë rajonet e Kukësit, Dibrës, Tropojës dhe Mirditës në veri dhe nga rajonet që përfshijnë Korçën, Elbasanin, Pogradecin. Arsyeja kryesore në bazë të kësaj rritjeje në lëvizjet e popullsisë mund t'i atribuohet kërkimit të një pune dhe një mënyre më të mirë jetese. Mjetet kryesore të jetesës vijnë nga emigracioni dhe bizneset e vogla në zonë. Shumica e shtëpive të cilat janë ndërtuar ilegalisht nuk janë regjistruar ende në Zyrën e Regjistrimit të Pronave të Paluajtshme, por ato janë subjekt i përpjekjes më të fundit për Legalizim. Gjithashtu, nuk ka statistika të sakta mbi nivelin e papunësisë, por një gjë që të bën më shumë përshtypje është niveli i lartë i papunësisë tek gratë, për shkak të pamundësisë së tyre për të gjetur një vend pune më afër gjinisë së tyre. Pjesë të mëdha të krahut të punës në Kamëz dhe Paskuqan në rajonin e Tiranës janë të papunë dhe kryesisht jetojnë me punë të përkohëshme si pjesë e ekonomisë informale. Në mënyrë të habitshme, papunësia prek shumë grup-moshën 16-34 vjeç për shkak të mungesës së përvojës apo aftësive profesionale. Burrat janë kryesisht të angazhuar në ndërtim apo çdo punë tjetër sezonale që hapen. Një pjesë e mirë e banorëve merren me vreshtari dhe blegtori gjë që u mundëson atyre të mbajnë veten dhe familjen.

Një pjesë tjetër e mirë e popullatës konsiderohet që shkojnë përditë në qytet dhe numri i tyre mund të jetë afër 15000.

5 LEGJISLACIONI DHE PROCEDURAT MBROJTËSE TË MJEDISIT

Sipas legjislacionit shqiptar mbi VNM, nuk kërkohet VNM për ndërtimin e shkollave. Për këtë arsye, ky Vlerësim Mjedisor përgatitet dhe bazohet në udhëzimet e Bankës Botërore mbi Vlerësimin Mjedisor përfshirë Planin e Administrimit Mjedisor.

5.1 PROCEDURA/SHQYRTIMI I NËNPROJEKTIT NGA BANKA BOTËRORE

Banka vlerëson çdo projekt përkundrejt politikave të veta mbrojtëse. Shqyrtimi mjedisor i Bankës mund të klasifikojë projektet si kategoria A (ndikime të rëndësishme negative mbi mjedisin), kategoria B (ndikime të mundshme negative mbi mjedisin, më pak të rënda se kategoria A) dhe kategoria C (mundësi për ndikime minimale apo asnjë ndikim negativ mbi mjedisin). Vlerësimi Mjedisor i kryer e konfirmon që projekti nuk do të ketë ndikime negative të rëndësishme, të pakthyeshme, grumbulluese apo afatgjata, dhe që nën projekte të mundshme të kategorisë A nuk do të financohen.

Megjithatë, për shkak se ndikimet e pritshme negative nuk do të jenë të rëndësishme apo të pakthyeshme, dhe sepse atom und të parandalohen apo pakësohen nëpërmjet veprimeve parandaluese apo masave zbutëse të përshtatshme, projekti klasifikohet si një projekt i kategorisë “B”, i cili kërkon vetëm një Vlerësim Mjedisor të pjesshëm në bazë të kësaj politike. Për të siguruar që këto çështje janë njohur, përshkruar dhe adresuar siç duhet, VM-të përgatiten për nën-projektet. Ky VM, me PAM e tij që siguron marrjen e veprimeve parandaluese apo masave zbutëse të rekomanduara, kënaq politikën OP 4.01 mbi Vlerësimin Mjedisor të Bankës Botërore.

Është përgatitur Manuali Operativ i Projektit (MOP), në të cilin është përshkruar procedura mjedisore e due diligence dhe e shqyrtimit të nën-projekteve. Edhe MOP përfaqëson planin e përgjithshëm të administrimit mjedisor. Procedura e shqyrtimit në MOP kërkon përgatitjen e dokumentave për Vlerësimin Mjedisor të fushave të ndryshme për secilin lloj nën-projekti siç paraqitet në tabelën 2, për arsye se investimet e parashikuara sipas projektit mund të kenë nivele të ndryshme të ndikimeve mbi mjedisin. Prandaj, për veprimtaritë e rehabilitimit të shkollave, seksioni i MOP në PAM përcakton masat zbutëse mjedisore dhe monitorimin mjedisor, ndërsa për zgjerimin apo ndërtimin e shkollave të reja brenda oborrit ekzistues MOP kërkon përgatitjen e një liste kontrolli të Planit të Administrimit Mjedisor (PAM) për secilin nën-projekt. Për ndërtimin e shkollave të reja në sheshe të reja, do të përgatiten Vlerësime Mjedisore me PAM meqënëse ndikimet do të varen nga sheshi i përzgjedhur, d.m.th. veprimtaritë e mëparshme në shesh, largësia nga vende të mbrojtura historike ose natyrore, etj. Dokumentet e Vlerësimit Mjedisor të kërkuara për nën-projektet janë dhënë tashmë në Tabelën 3. Për shkak të nevojës për blerje toke, projekti ka vënë në punë politikën e Zhvendosjes së Detyruar (OP/BP 4.12). Blerja e tokës do të bëhet në përputhje me Planin e Blerjes së Tokës dhe Zhvendosjes, që është përgatitur.

Tabela 5 Tabela e shqyrtimit mjedisor të nën-projekteve

Llojet e veprimtarive të	Dokumentacioni i kërkuar për Vlerësimin Mjedisor	I zbatueshëm për:
--------------------------	--	-------------------

kategorisë B		
1	Vlerësimi Mjedisor (VM) me Planet e Administrimit Mjedisor (PAM) për secilin ndërtim individual (nën-projekt)	Shkollat e reja në sheshe të rinj
2	PAM specifike për sheshin, për secilën shkollë në formën e një liste kontrolli	Shkolla të reja apo zgjerime në oborret ekzistuese të shkollave.
3	Nuk është i nevojshëm një PAM. Zbatohen masat e përgjithshme të përshkruara në MOP	Rehabilitimi i shkollave ekzistuese në oborret ekzistuese të shkollave.

5.2 LEGJISLACIONI MJEDISOR SHQIPTAR

Legjislacioni mjedisor kryesor është Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 8934, datë 5 Shtator 2002. Ky Ligj përcakton politikat kombëtare dhe vendore për mbrojtjen e mjedisit, kërkesat për përgatitjen e vlerësimeve të ndikimit mbi mjedisin dhe vlerësimin strategjik mjedisor, kërkesat për dhënien e lejeve veprimtarive që ndikojnë mbi mjedisin, parandalimin dhe pakësimin e ndotjes së mjedisit, normat dhe standartet mjedisore, monitorimin dhe kontrollin mjedisor, detyrat e organeve shtetërore në lidhje me çështjet mjedisore, rolin e publikut dhe sanksionet e përcaktuara në rast të shkeljes të Ligjit.

Ligji për Vlerësimin e Ndikimit mbi Mjedisin, Nr. 8990, u miratua në 23 Janar 2003. Ai përcakton rregullat, procedurat dhe afatet për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve të drejtpërdrejt apo të tërshorta të projekteve ose veprimtarive mbi mjedisin. Ligji përcakton hapat e nevojshme për zbatimin e procedurave të VNM: dorëzimin e kërkesës, shqurtimin paraprak, kriteret e përzgjedhjes dhe klasifikimit, seancat dëgjimore dhe konsultimet publike, aksesin në informacion, detyrat dhe të drejtat e organeve të tjera. Ligji përcakton gjithashtu listën e veprimtarive që duhet të jenë objekt i procesit të Thelluar dhe të Përmbledhur të VNM.

Sipas Ligjit mbi VNM, për ndërtimin e shkollave nuk kërkohet as Vlerësim Mjedisor i thelluar dhe as i përmbledhur.

6 NDIKIMET E MUNDSHME MJEDISORE

Ndikimet mjedisore të projektit priten të jenë të administrueshme, të përkohshme dhe me ndikim lokal, meqenëse ato janë të lidhura me veprimtaritë e përgjithshme ndërtimore mbi një vendndodhje që njihet tashmë. Ato zakonisht përfshijnë: a) Pluhur dhe zhurma për shkak të gërmimit, shkatërrimit dhe ndërtimit; b) Administrim i mbetjeve të shkatërrimit dhe të ndërtimit dhe derdhjes aksidentale të vajrave dhe lubrifikanteve, , etj., c) Cënimi i kufijve të një prone private; d) Rrezik dëmtimi të pronave historike ose kulturore apo vendeve të panjohura arkeologjike; e) Shqetësimi i trafikut, f) ndikime / dëmtime të ekosistemeve, dhe g) ndikime mbi hidrologjinë e zonës. Ndikimet që janë specifike për sheshin janë detajuar më shumë në seksionet 6.1, 6.2, dhe 6.3. Në të njëjtin seksion i kushtohet një vëmendje e veçantë përshkrimit të sheshit të përzgjedhur dhe ndikimeve të tanishme mbi të.

6.1 NDIKIMET MBI MJEDIS TË LIDHURA ME VETË VENDNDODHJEN

Vendi i përzgjedhur për shkollën, me karakteristikat e tij të tanishme mund të ketë ndonjë ndikim mbi veprimtaritë e ardhshme. Janë identifikuar disa çështje shqetësuese:

- a) sheshi përzgjedhur është një zonë e mundshme përmbytjeje nga lumi i Tiranës,
- b) brigjet e lumit të Tiranës, që janë rreth 100 metra nga sheshi i ardhshëm i shkollës janë të mbingarkuara me mbetje të ngurta.
- c) analiza e dheut në sheshin e shkollës së ardhshme tregoi përqëndrim më të lartë të Cr, Mn dhe Ni,
- d) ndërtimi i rrugës së ardhshme Babrru – Bregu i Lumit – Kthesa e Kamzës do të ketë ndikim mbi cilësinë e ajrit, zhurmën dhe sigurinë.

Zona e përmbytjes

Pika më afërt e sheshit për shkollën është rreth 90 – 100 metra larg nga lumi, dhe për këtë arsye, komuna e Paskuqanit kërkoi në Korrik 2007 një mendim mbi hidrologjinë nga Instituti Shtetëror i Hidrometeorologjisë – duke kërkuar analizën e efektit të një plote 10 vjeçare. Mendimi i institutit doli në Shtator 2007 (shih shtojcën). Përlllogaritjet treguan që një valë 100 vjeçare paraqitet nga një rrjedhë prej 550 m³/s. Kjo valë mund të arrijë kuotën e lartësisë prej 89.3 metra, ndërsa shkolla është e vendosur në kuotën 89.9 m. Ndërkohë që këto llogaritje do të thonë që vala 100 vjeçare nuk do të mbërrijë shkollën (d.m.th. do të ndalonte 0.6 m poshtë shkollës) kufiri i sigurisë është i ulët, kështu që do të merren masa për të mbrojtur shkollën nga impakte të përmbytjeve të mundshme.




Figura 8 Vala e përmbytjes

Ndërtimi i sistemit të ri të kanalizimeve i cili do të përfshijë masat e administrimit të lumit si dhe ndërtimin e rrugës Babrru – Bregu i Lumit – Kthesa e Kamzës do të përmirësojë dukshëm mbrojtjen ndaj përmblytjeve, meqenëse këto të dyja do të kenë një rezultat në rregullimin e rrjedhës së lumit të Tiranës.

Mbetjet në brigjet e lumit

Brigjet e lumit të Tiranës janë të mbingarkuara me mbetje të ngurta. Gjendja është e njëjtë pranë shkollës. Figurat e mëposhtme paraqesin gjendjen në brigjet e lumit. Qeveria e Shqipërisë nëpërmjet Ministrisë së Transportit ka nënshkruar një projekt me Mankën Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për sistemin e kullimit të lumenjve të Tiranës së Madhe. Megjithatë, ky projekt do të përqendrohet mbi ndërtimin e sistemit të kanalizimeve, si dhe pastrimin e mbetjeve nga brigjet e lumenjve dhe zbatimin e masave të mbrojtjes nga përmblytjet në pjesë të lumit të cilat duhet të përcaktohen.

Shkolla duhet të lidhet me sistemin e furnizimit me ujë dhe jo me pusët lokale për të minimizuar rreziqet shëndetësore të lidhura me furnizimin me ujë të pijshëm. Planet fizike të projektit të shkollës së Paskuqanit duhet ta pasqyrojnë një gjë të tillë. Komuna duhet të rezervojë fonde për pastrimin e brigjeve të lumit në afërsi të shkollave nëse projekti (rruga dhe kanalizimet) nuk ndjek ritmin e ndërtimit të shkollës. Letra e mbështetjes nga kryetari i komunës së Paskuqanit është paraqitur në shtojcë.



Figura 9 Pamja e brigjeve të lumit të Tiranës nga ura e Paskuqanit



Figura 10 Pamja nga bregu i djathtë drejt anës së majtë të lumit të Tiranës (largësia nga shkolla rreth 100 m)

Cilësia e dheut

Analiza e dheut rreth vendit të shkollës së ardhshme tregoi nivele të rritura të Mn, Ni dhe Cr. Sipas Fakultetit të Shkencave të Natyrës këto rezultate lidhen me karakteristikat natyrore gjeologjike të zonës (shih shtojcën). Për shkak të rrezikut të mundshëm shëndetësor nga pluhuri, duhet të zbatohen masa parandalimi dhe kontrolli si heqja e shtresës së sipërme të dheut, vendosja e një shtrese të re të pastër ose vulosja e sipërfaqeve për të parandaluar prodhimin dhe gëlltitjen e pluhurit, dhe shmangja e instalimit të një pusi dhe përdorimi i ujërave nëntokësore për pirje apo ujitje të bimëve të ngrënshme. Nëse ekipi i projektuesve do të zgjedhë zhveshjen e dheut (rreth 20 cm) apo vulosjen e dheut do të varet nga qëllimi i sipërfaqes. Për shembull, të gjithë zonat e gjelbra duhet të zhvishen dhe

dheu të zëvendësohet. Për rrugicat dhe rrugët e aksesit do të mjaftojë vulosja e sipërfaqes me loje të tjera materiali. Projekti duhet të miratohet nga konsulenti mjedisor në MASH. Shtresa e sipërme e hequr e dheut duhet të depozitohet në një mënyrë të sigurtë larg vendit të shkollës.

Rruga e ardhshme

Qeveria e Shqipërisë, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, ka caktuar një buxhet të disponueshëm për vitet 2008-2009 dhe i ka dhënë kontratën nr. 10234/6 datë 31.12.2008 “ J.V Klodiota & Sphaera & G & K” shpk për projektimin e rrugës “Babrru – Bregu i Lumit – Kthesa e Kamzës”. Pjesa më e madhe e rrugës do të ndërtohet përgjatë brigjeve ekzistuese të lumit. Projekti rrugor do të lehtësojë pastrimin e brigjeve si dhe rregullimin e lumit të Tiranës, gjë që do të minimizojë mundësitë për përmbytje.

Paramentrat e rrugës do të jenë si më poshtë: një gjerësi të gjurmës ekzistuese prej 7.5 m (2 x 3.75); kuneta me gjerësi 0.5 m, korsi parkimi me gjerësi 2.5 m; trotuare me gjerësi 3 dhe 5 m; brez i gjelbër 2-3 m; gjerësi të përgjithshme të rrugës 21 m ose 29 m; gjerësi të përgjithshme të kursorës së objektit 105 m ose 120 m; kufiri i shpejtësisë i bazuar mbi prospektin gjeometrik të rrugës do të jetë 80 km/orë (kjo shpejtësi mund të kufizohet më tej nga autoritetet e Paskuqanit në afërsi të shkollës).

Zona sportive e shkollës (shih figurën 1), e cila është më e afërta me rrugën e ardhshme, është 50 m larg rrugës, që do të thotë se ndërtesa e shkollës është rreth 80 m larg. Për shkak të afërsisë së rrugës me shkollën, duhet të zbatohen masa shtesë mbrojtjeje për të minimizuar impaktin e zhurmës dhe për të rritur sigurinë. Këto masa duhet të përfshijnë një mur për mbrojtjen ndaj zhurmës, rrethimi dhe ndalimi i aksesit në rrugë si dhe kufizimi i shpejtësisë në atë segment të rrugës. Për të ulur impaktin e zhurmës mbi stafin e shkollës dhe fëmijët duhet të përgatitet një *Vlerësim i Reduktimit të Zhurmës*. Vlerësimi i Mbrojtjes nga Zhurma duhet të identifikojë masat teknike (lloji i izolimit, muret e mbrojtjes nga zhurmat, etj.) për të ruajtur nivelet e zhurmave në 35 – 40 dB në godinën e shkollës. Këto masa teknike duhet të përfshihen në projektin Kryesor dhe të shqyrtohen nga konsulenti mjedisor i MASH. Gjithashtu, gjatë zgjedhjes së materialeve të ndërtimit për shkollën, duhet të preferohen materialet me izolim më të mirë akustik.




Figura 11 Lumi i Tiranës siç është në afërsi të shkollës së ardhshme




Figura 12 Rruga e ardhshme në afërsi të shkollës

6.2 NDIKIMET MJEDISORE GJATË FAZËS SË NDËRTIMIT DHE MASAT ZBUTËSE PËRKATËSE

Ndikimet mjedisore gjatë fazës së ndërtimit janë të lidhura me ndërtimet tipike, siç janë ndikimet e lidhura me ndotjen e ajrit, prodhimin e mbetjeve, zhurmat, ndotjen e dheut dhe ujit dhe rreziqet e mundshme të sigurisë.

6.2.1 Ndotja e Ajrit

Veprimtaritë e ndërtimit mund të shkaktojnë përhapjen e pluhurave në atmosferë dhe një pakësim të ndjeshëm të cilësisë së ajrit lokal, kryesisht për shkak të kalimit të automjeteve mbi sipërfaqet e pashtuara, kalimi i automjeteve me ngarkesë të pambuluar dhe nëpërmjet shkarkimeve të makinerive të mbajtura keq. Këto ndikime mund të pakësohen në nivele minimale nëpërmjet adoptimit të praktikave standarte të mirë administrimit të shesheve, siç është spërkatja me ujë për të kufizuar shkarkimet e pluhurit në zonën afër materialeve të ndërtimit dhe në rrugët e pa-asfaltuara, mbulimi i sipërfaqeve me mbulesa plastike gjatë magazinimit dhe transportimit të materialeve, kufizimi i shpejtësisë së automjeteve në zonë dhe në rrugët hyrëse, pastrami periodik i sheshit të ndërtimit dhe rrugëve hyrëse, përdorimi eficient i makinerive moderne të ndërtimit për të minimizuar shkarkimet, të cilat janë të pajisura me mbytës zhurmash dhe mirëmbahen në gjendje të mirë dhe eficiente pune. Gjatë punimeve të dheut duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë mbrojtjes së punëtorëve për shkak të përqendrimeve më të larta të Cr, Ni dhe Mn në dheun e zonës.

Për të minimizuar pluhurat nga grumbullimi i materialeve, periudha e mbajtjes e materialeve duhet të reduktohet në minimum, për të minimizuar ekspozimin e tyre ndaj erozionit të erës.

6.2.2 Prodhimi i mbetjeve

Prodhimi i mbetjeve pritet të ketë ndikimin më të rëndësishëm mjedisor. Punimet e parashikuara në kuadrin e projektit do të prodhojnë disa lloje mbetjesh. Ato janë klasifikuar sipas katalogut evropian të mbetjeve dhe listës së mbetjeve të rrezikshme meqënëse Republika e Shqipërisë po përafron legjislacionin me atë të BE-së. Në këtë kapitull janë paraqitur vetëm emri i grupeve të mbetjeve, të shënuar me numra sinë katalogun evropian të mbetjeve. Në secilin grup, llojet e mbetjeve mund të shënohen me yll (*) i cili përfaqëson mbetjet e rrezikshme. Nën-grupi i saktë i mbetjeve me numrin e tij identifikues do të identifikohet në vendndodhje.

Llojet e grupeve kryesore të mbetjeve që mund të priten në zonë mund të jenë si më poshtë por nuk përjashtohen mbetje të tjera:

08 Mbetjet nga prodhimi, formulimi, furnizimi dhe përdorimi i shtresave (bojra, verniqeve dhe smalteve të qelqta), izolantëve dhe bojrave të printimit;

13 Mbetjet e vajrave dhe mbetjet e karburanteve të lëngshme (siç janë vajrat hidraulike nga pajisjet)

- 15 Mbetjet e paketimeve; absorbentët, lekat për fshirje, materialet e filtrave dhe veshjet mbrojtëse, të cilat nuk specifikohet ndryshe;
- 17 Mbetjet e ndërtimit dhe shembjeve (përfshirë dheun e gërmuar nga vendet e ndotura);
- 20 Mbetjet komunale (mbetjet e familjeve, dhe mbetje të ngjashme tregtare, industriale dhe institucionale) përfshirë copat e mbledhura veçmas.

Masat parandaluese të administrimit të mbetjeve

Mbetjet e rrezikshme priten në sasi të vogla. Në ndërtimet e reja ato do të përfshijnë mbetje të ndryshme të verniqeve, bojrave, si dhe mbetjet e vajrave nga pajisjet. Këto mbetje nuk duhet të përzihen me mbetjet e ngurta. Kontraktori është i detyruar të ketë kontejnerë të veçantë të etiketuar për këto lloj mbetjesh.

Për mbetjet e rrezikshme, kontraktori duhet të ndjekë procedurën e ndarjes së mbetjeve të rrezikshme në vend. Kontraktori duhet t'i dorëzojë mbetjet tek kompania e autorizuar për administrimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të plotësojë dokumentacionin shoqërues i cili duhet të mbahet si provë e praktikës së mirë në administrimin e mbetjeve.

Është shumë e rekomandueshme të ndahen llojet e ndryshme të mbetjeve (ambalazhet plastike dhe të qelqit), për të cilat ekzistojnë sisteme të veçanta grumbullimi/riciklimi në vend, nga ato mbetje që janë të pariciklueshme dhe të dërgohen në pikat e përshtatshme të grumbullimit së bashku me dokumentacionin shoqërues.

Mbetjet e pariciklueshme duhet të dërgohen në një landfill të miratuar.

Sheshi i ndërtimit do të pastrohet dhe të gjithë hedhurinat dhe materialet e mbetjeve do të eliminohen në përputhje me klauzolat e specifikuar në preventivat.

Djegia apo hedhja e paligjshme e mbeturinave është rreptësisht e ndaluar.

Mbetjet komunale dhe mbetjet e tjera do të duhet të mblidhen në kontejnerë të veçantë për këtë qëllim dhe të largohen rregullisht.

Dheu i gërmuar nga sheshi, për shkak të përqendrimit të lartë të Cr dhe Ni duhet të hiqet dhe të depozitohet në një vend i cili do të miratohet së bashku me Ministrinë e Mjedisit dhe autoritetet në Paskuqan. Përpara largimit të dheut të gërmuar, sheshi duhet të vizitohet edhe nga konsulenti mjedisor i MASH i cili do të informojë Bankën në lidhje me zgjedhjen, duke dhënë një justifikim të shkurtër për sheshin.

6.2.3 Zhurmat

Zhurmat janë një ndikim i pashmangshëm mbi mjedisin gjatë ndërtimit. Zhurma mund të kufizohet duke ndjekur praktikën e mirë-administrimit (pajisje/makineri të kalibruara) që nënkuptojnë se punimet do të kryhen vetëm gjatë orarit të rregullt të turneve të punës.

Pajisjet e ndërtimit do të plotësojnë të gjithë standartet e zbatueshme të Direktivës së BE 2000/14/EC, e Majit 2000. Kjo Direktivë zbatohet për prodhuesit e pajisjeve që shkaktojnë zhurmë. Të gjithë pajisjet duhet të mirëmbahen në gjendje të mirë pune.

Oraret e transportimit të materialeve të ndërtimit në rrugët e daljes do të caktohen me kujdes në mënyrë që të mënjanohet çdo shqetësim i trafikut lokal. Funksionimi i sheshit do të ndalohet nga ora 19.00 – 7.00, çdo ditë.

6.2.4 Ndotja e dheut dhe ujit

Nuk pritet ndotje e dheut dhe ujit, meqënëse ajo mund të parandalohet. Megjithatë, disa rritje të ndotjes së ujit dhe dheut mund të shkaktohen nga ndotjet e drejtpërdrejta apo të tërthorta për shkak të derdhjeve aksidentale apo përdorimit të pakujdesshëm të materialeve të rrezikshme si karburantet, lubrifikantët e pajisjeve, bojrat, verniqet, etj.

Ndikimet e mundshme dhe pasojat e tyre mbi ujrat sipërfaqësore gjatë ndërtimit, përfshijnë: magazinimin e pasaktë të karburanteve nga kotnraktori dhe veprimtaritë në shesh që mund të sjellin ndonjë derdhje aksidentale të lëngjeve apo rrjedhjeve të ndotura, dhe përkeqësimi si pasojë e cilësisë së ujrave sipërfaqësore. .

Sheshi do të ketë masa të përshtatshme për kontrollin e erozionit dhe sedimenteve, siç janë dengjet e kashtës dhe rrethimet me baltë për të parandaluar lëvizjen e sedimenteve dhe shkaktimin e turbullirave të tepërta në kanalet e afërta.

Mbajtja e materialeve të stivosura të ndërtimit duhet të shmanget. Nëse kërkohet përkohësisht, duhet të krijohet kushte të përshtatshme magazinimi në sheshin e ndërtimit, si p.sh. përdorimi i mbulesave për mbrojtjen ndaj kushteve atmosferike. Materialet e rrezikshme (lubrifikantët, vajrat, etj.) duhet të mbahen mbi sipërfaqe të papërshkueshme, dhe absorbentët si rëra apo tallashi duhet të jenë të disponueshme për trajtimin e shpejtë të derdhjeve aksidentale. Të gjithë materialet duhet të trajtohen në përputhje me udhëzimet e përfshira në Material Safety Data Sheets (MSDS) të ndodhura në sheshin e ndërtimit. Trainimi i personelit operativ si dhe personelit ndërtues do të vazhdojë.

Nëse do të ketë nevojë për instalimin e depozitave për karburantet, ato do të kenë depozita dytësore me volum të mjaftueshëm për të mbajtur një derdhje nga depozita më e madhe në strukturë. Zona e mbajtjes do të ketë një mjet (pompa) për të hequr ujin e grumbulluar.

Për burimet e materialeve do të përdoren vetëm veprimtari të licënuara të guroreve, asfaltit dhe çakullit.

Nuk duhet të hidhet dheu sipërfaqësor i hequr, por të ruhet në shesh për rehabilitim pas përfundimit të punimeve. çdo pemë ekzistuese dhe bimësi e vlefshme duhet të ruhet gjithashtu dhe të përdoret më vonë për rehabilitim.

6.2.5 Zbulimet rastësore

Nuk ka zona të rëndësishme arkeologjike në afërsi të sheshit, prandaj nuk kërkohen masa të veçanta mbrojtëse arkeologjike. Megjithatë, nëse gjatë gërmimeve zbulohen disa mbetje arkeologjike, punimet do të ndërpriten menjëherë dhe do të informohet autoriteti lokal kompetent. Punimet do të rifillojnë vetëm pasi të jenë marrë masat e duhura, të kërkuara nga autoriteti përkatës dhe të jetë marrë konfirmimi që punimet mund të vazhdojnë.

6.3 NDIKIMET MJEDISORE GJATË FAZËS SË FUNKSIONIMIT

Ndikimet mjedisore gjatë fazës së funksionimit të cilat lidhen me investimet e projektit lidhen kryesisht me prodhimin e mbetjeve dhe trajtimin e substancave të rrezikshme në laboratore.

6.3.1 Prodhimi i mbetjeve

Mbetjet e prodhuara gjatë funksionimit lidhen me veprimtaritë e mirëmbajtjes dhe veprimtaritë e rregullta të funksionimit të shkollës.

Llojet e mundshme të mbetjeve janë klasifikuar sipas katalogut evropian të mbetjeve dhe listës së mbetjeve të rrezikshme meqënëse Republika e Shqipërisë po përafrohet legjisllacionin me atë të BE-së. Mbetjet e shënuara me yll (*) në katalog përfaqësojnë mbetjet e rrezikshme.

Mbetjet (të rrezikshme dhe të parrezikshme) duhet të ndahen, ruhet dhe grumbullohen sipas Ligjit mbi Mbetjet.

Mbetjet e rrezikshme (që përfshin substancat kimike të laboratorëve dhe ambalazhet e tyre – grupi 15 sipas katalogut të mbetjeve) paraqesin shqetësimin kryesor. Duhet të vendosen tabela të veçanta dhe MSDS në laborator dhe në afërsi të lavamanëve për të shmangur derdhjen e substancave kimike në lavaman dhe përzjerjet e rrezikshme. Në fillim të vitit shkollor, një mësues i shkencave duhet t'i kushtojë një osë shkollore trajtimit të substancave kimike.

Në laboratorë duhet të ketë kontejnerë të veçantë ku të hidhen substancat dhe ambalazhi i tyre. Trajtimi i mbetjeve kimike duhet të bëhet nga mësuesit e shkencave. Përveç kësaj, duhet të ketë kontejnerë të veçantë për grumbullimin e kimikateve të derdhura.

Mbetjet duhet të dorëzohen në kompaninë e autorizuar për mbetjet e rrezikshme, e cila duhet t'i japë shkollës dokumentacionin mbi metodat e eliminimit.

Mbetjet komunale duhet të grumbullohen nga kompania që trajton mbeturinat dhe të dërgohen në landfill.

Grupet kryesore të mbetjeve që priten janë si më poshtë, por nuk përjashtohen lloje të tjera: ambalazhet, substance kimike, dhe mbetje komunale.

7 PLANI I ADMINISTRIMIT MJEDISOR

Plani aktual i Administrimit Mjedisor (PAM) përfshin masat për të trajtuar ndikimet e mundshme gjatë përgatitjes së veprimtarive të ndërtimit dhe funksionimit të shkollës. Plani Zbutës me ndikimet, masat dhe palët përgjegjëse të identifikuara, paraqitet në tabelat 4, 5 dhe 6 ndërsa Plani i Monitorimit për këto masa zbutëse përfshihet në tabelën 7.

Gjatë ndërtimit, kontraktori do të zbatojë të gjithë masat mjedisore zbutëse. MASH do të këshillohet me ekipin e Bankës Botërore rreth pranimin të projektit dhe masat e propozuara që priten të zbatohen përpara ndërtimit. MASH, Komuna dhe Inxhinieri Mbikqyrës (konsulent i kontraktuar nga MASH) do të monitorojnë zbatimin e PAM gjatë fazës së ndërtimit. Gjatë fazës së funksionimit, masat zbutëse mjedisore do të zbatohen nga personeli i shkollës. Mbikqyrja gjatë funksionimit do të bëhet nga mësuesit e shkencave dhe inspektorët e ARM. Ndikimet e përgjithshme të mundshme mbi mjedisin dhe sigurinë janë të mundura të shmangen dhe mund të mënjanojnë lehtësisht duke adoptuar praktika të mira inxhinierike.

MASH do të sigurojë që dokumentet e kontratës të përfshijnë dispozitat përkatëse të mbrojtjes së mjedisit dhe që PAM do të jetë një pjesë integrale e kontratës. Kontraktori që do të kryejë punimet e ndërtimit do të ndjekë dhe kërkesat e rregulloreve aktuale të ndërtimit dhe ato mjedisore. Për të siguruar një shkallë ndikimi mbi performancën mjedisore të Kontraktorit, do të futet një klauzolë e përshtatshme në kontratat e punimeve, që specifikon ndëshkimet në rast të mospërputhjes me dispozitat mjedisore të kontratës, p.sh. në formën e mbajtjes së një pjese të pagesës, madhësia e të cilës varet nga rëndësia e shkeljes së kontratës. Në raste të tejskajshme, do të përfshihet në kontratë dhe ndërprerja e kontratës. Raporti i monitorimit nga ana e inxhinierit që mbikqyr punimet do të jetë një kusht për pagesën e plotë të kontratës, e njëvlefshme me kriteret e cilësisë teknike apo vëzhgimet sasiore. Përputhja me rregulloret shqiptare dhe termat e PAM të tanishëm do të monitorohen dhe verifikohen gjatë vizitave të rregullta nga inxhinieri Mbikqyrës dhe vizita të rastësishme në terren nga specialisti mjedisor i MASH dhe përfaqësuesit e komunës. Inxhinieri Mbikqyrës do të mbikqyrë punimet e ndërtimit dhe zbatimin e PAM. Inxhinieri Mbikqyrës do të përgatisë raporte dy-javore mbi zbatimin e PAM për MASH: e: a) për të siguruar që është i përditësuar dhe i lidhur me gjendjen në terren; b) për të siguruar që veprimet e mospërputhjes dhe rregulluese janë dokumentuar siç duhet; c) për të shqyrtuar gjendjen e zbatimit; dhe, d) për të vlerësuar përgjigjet korrigjuese të kontraktorit. Rezultatet e këtyre vizitave do të raportohen në raportet e mbikqyrjes të dorëzuara çdo dy javë nga Inxhinieri Mbikqyrës, bazuar në konsultimet me Kontraktorin. Inxhinieri Mbikqyrës do t'i kushtojë vëmendje çdo çështjeje të re kritike që mund të shfaqet gjatë punimeve të ndërtimit dhe do të informojë MASH dhe do të sugjerojë veprime për agjenci të ndryshme. MASH do të raportojë rregullisht në Bankë mbi progresin. Raportet gjashtëmujore mbi përputhshmërinë do t'i dorëzohen Bankës.

MASH, së bashku me drejtuesit e shkollës dhe ekipin e mirëmbajtjes duhet të zbatojnë masat zbutëse të PAM gjatë funksionimit.

Autoritetet përkatëse qeveritare do të përfshihen në auditimin e performancës së projektit dhe do të marrin kopje të raporteve të monitorimit. Tabelat 4, 5 dhe 6 përmbledhin veprimtaritë e propozuara të monitorimit në kuadrin e projektit dhe specifikojnë vendin, shpeshësinë dhe kohëzgjatjen e monitorimit.

Tabela 6 Masat Zbutëse Mjedisore dhe veprimet e kërkuara përpara Fazës së Ndërtimit

Ndikimi për shkak të:	Masë Zbutëse e Ndikimit	Vendi dhe koha e performancës	Fondet e zbatimit	Personi Përgjegjës	Funksioni i kontrollit nga:
Sheshi i shkollës në një zonë të mundshme përmblytjeje	<p>Megjithëse sheshi i shkollës nuk pritet të preket nga një vërshim 10 vjeçar, projekti duhet t'ë përfshijë masa mbrojtëse ndaj përmblytjeve, që nga zgjedhja e materialeve dhe lloji i themeleve për të minimizuar rrezikun e dëmtimeve, kanale debijimi, projektim të rrugëve të aksesit në emergjenca.</p> <p>Duhet të përgatitet një plan i detajuar të evakuimit në rast emergjencash, dhe projektimi duhet të pasqyrojë daljet dhe rrugët e emergjencave.</p>	Faza e projektimit, përpara ndërtimit	Kostot mund të jenë të mëdha, duhet të përballohen nga Komuna e Paskuqanit dhe të përfshihen në fazën e projektimit.	Komuna e Paskuqanit, projektuesi	MASH, Inspektorët e ARM, Inspektorati ndërtimor
Afërsia e rrugës Babrru – Bregu i Lumit – Kthesa e Kamzës	Për shkak të afërsisë së rrugës me vendin e ndërtimit të shkollës, duhet të zbatohen masa shtesë për të minimizuar impaktin e zhurmës dhe për të rritur sigurinë. Masat kundër zhurmave duhet të projektohen të tilla që zhurma të arrijë nivelin 35 – 40 dB në ndërtesën e shkollës. Këta masa, të paraqitura në reduktimin e zhurmës, mund të përfshijnë mur mbrojtës ndaj zhurmave, rrethim dhe parandalimin e aksesit në rrugë si dhe kufizimin e shpejtësisë në atë segment rruge.	Faza e projektimit, përpara ndërtimit	Kostot mund të jenë të mëdha, duhet të përballohen nga projektuesi ose Komuna e Paskuqanit dhe të përfshihen në fazën e projektimit.	Komuna e Paskuqanit, projektuesi	MASH, Inspektorët e ARM, Inspektorati ndërtimor
Përqëndrime më të larta të Cr, Ni dhe Mn në dhé.	Masa parandalimi dhe kontrolli mund të përfshijnë heqjen e shtresës së sipërme të dheut, vendosjen e një shtrese të re dheu të pastër ose çdo shtrese tjetër për të parandaluar prodhimin dhe gëlltitjen e pluhurit, dhe shmangien e instalimit të një pusi në vend dhe përdorimit të ujit nëntokësor për pirje apo ujitje të bimëve të ngrënëshme. Nëse ekipi i projektuesve do të zgjedhë zhveshjen e dheut (rreth 20 cm) apo vulosjen e dheut do të varet nga qëllimi i sipërfaqes. Për shembull, të gjithë zonat e gjelbra duhet të zhvishen dhe dheu të zëvendësohet. Për rrugicat dhe rrugët e aksesit do të mjaftojë vulosja e sipërfaqes me loje të tjera materiali.	Faza e projektimit, përpara ndërtimit	Kostot mund të jenë të mëdha, duhet të përballohen nga projektuesi ose Komuna e Paskuqanit dhe të përfshihen në fazën e projektimit.	Komuna e Paskuqanit, projektuesi	MASH, Inspektorët e ARM, Inspektorati ndërtimor. Projekti duhet të miratohet nga konsulenti mjedisor i MASH.

<p>Afërsia e mbetjeve të hedhura në brigjet e lumit.</p>	<p>Megjithëse ka një projekt në përgatitje që do të lehtësojë pastrimin e brigjeve të lumit, duhet të merren masa parandaluese. Projekti duhet të përfshijë rrethim rrotull shkollës si një masë sigurie, për të parandaluar kalimin e fëmijëve në bregun e lumit. Komuna duhet të mbështesë pastrimin e brigjeve në afërsi të shkollës nëse projekti (rrugë dhe kanalizime) nuk ndjek ritmin e ndërtimit të shkollës (shih letrën në shtojcë),.</p> <p>Gjithashtu, për shkak të ndotjes së dukshme të lumit të Tiranës, shkolla duhet të lidhet me ujësjellësin dhe jo me pusët lokale.</p>	<p>Faza e projektimit, përpara ndërtimit</p>	<p>Kostot mund të jenë të mëdha, duhet të përballohen nga Komuna e Paskuqanit.</p>	<p>Komuna e Paskuqanit</p>	<p>MASH, Inspektorët e ARM, Inspektim ndërtimi</p>
--	--	--	--	----------------------------	--

Tabela 7 Masat Zbutëse Mjedisore për fazën e Ndërtimit

Ndikimi për shkak të:	Masë Zbutëse e Ndikimit	Vendi dhe koha e performancës	Fondet e zbatimit	Personi Përgjegjës	Funksioni i kontrollit nga:
<p>Ndotja e ajrit e lidhur me zhvendosjen e materialeve, stivosjen dhe makineritë në gjendje të keqe pune.</p>	<p>Pluhuri nga transportimi i materialeve të ndërtimit dhe mbetjeve do të minimizohet me anë të përdorimit të ujit, duke minimizuar shpejtësinë e automjeteve dhe mbulimin e ngarkesave në rastet kur e kërkon inxhinieri mbikëqyrës. Në rrugët hyrëse, transporti duhet të kufizohet gjatë orëve të mbingarkesës.</p> <p>Pluhuri nga stivosja duhet të parandalohet, me anë të mbulimit të materialeve dhe reduktimit të periudhës që ato mbahen në shesh.</p> <p>Trotualet dhe rrugët duhet të mbahen të pastra nga mbetjet për të minimizuar pluhurin.</p> <p>Të gjithë automjetet duhet të mirëmbahen në një gjendje të mirë dhe të kenë dëshmi. Gjatë punës për gjermimin e dheut, punëtorët duhet të pajisen me maska. Për të minimizuar prodhimin e pluhurit gjatë gjermimit, dheu duhet të laget pak. Materialet e stivuara përkohësisht duhet të mbulohen.</p>	<p>Gjatë ndërtimit</p>	<p>Mund të jenë të mëdha</p> <p>Detyrimi i kontraktorit mund t'i transferohet kontraktorit me miratimin e Komuna e Paskuqanit / MASH</p>	<p>Kontraktori</p>	<p>Inxhinieri mbikëqyrës i punimeve, MASH, Inspektorët e ARM,</p>

Mbetjet	<p>Shtigjet dhe vendet e grumbullimit dhe depozitimit të mbeturinave duhet të identifikohen për secilin nga llojet kryesore të mbetjeve që priten nga veprimtaritë e ndërtimit.</p> <p>Llojet e ndryshme të mbetjeve duhet të ndahen dhe të ruhen në kontejnerë të përshtatshëm në shesh.</p> <p>Mbetjet duhet të grumbullohen nga grumbullues të licensuar.</p> <p>Regjistrat e largimit të mbetjeve do të mbahen si provë e mirë-administrimit.</p> <p>Sa herë që është e mundur, kontraktori do të ripërdorë dhe riciklojë materialet e përshtatshme.</p> <p>Mbetjet e rrezikshme priten të jenë në sasi të vogla dhe duhet të ndahen nga mbetjet e ngurta, d.m.th. të grumbullohen në kontejnerë të veçantë. Mbetjet e rrezikshme mund të përfshijnë, por nuk kufizohen më verniqet dhe mbetjet e bojërave, lubrifikantë të derdhur apo të mbetur nga pajisjet, bateritë, etj.</p> <p>Për mbetjet e rrezikshme kontraktori duhet të ndjekë procedurën për administrimin e mbetjeve të rrezikshme, kjo nënkupton grumbullimin, dorëzimin e mbetjeve tek kompania e autorizuar për administrimin e mbetjeve të rrezikshme dhe duke plotësuar dokumentacionin shoqërues.</p> <p>Djegja ose hedhja e paligjdhme e mbetjeve është rreptësisht e ndaluar.</p> <p>Dheu i gërmuar në shesh, për shkak të përmbajtjes së lartë më Cr dhe Ni duhet të hiqet dhe të depozitohet në një vend që do të miratohet së bashku me Ministrinë e Mjedisit.</p> <p>Dheu i gërmuar në shesh, për shkak të përmbajtjes së lartë me Cr dhe Ni duhet të hiqet dhe të hidhet në vendin e miratuar nga Ministria e Mjedisit.</p>	Gjatë gjithë kohës së ndërtimit	Mund të jenë të mëdha Detyrimi i kontraktorit mund t'i transferohet kontraktorit me miratimin e Komuna e Paskuqanit/MASH	Kontraktori	Inxhinieri mbikqyrës i punimeve, MASH, Inspektorët e ARM
---------	--	---------------------------------	---	-------------	--

Zhurmat	Kufizoni punën nga ora 7.00 në 19:00. Zbatoni masat e përgjithshme parandaluese për zbutjen e zhurmave në sheshin e ndërtimit (certifikim i pajisjeve). Pajisjet e ndërtimit duhet të plotësojnë standartet e Direktivës së BE 2000/14/EC, Maj 2000.	Gjatë gjithë kohës së ndërtimit	Pjesë e praktikës së zakonshme të kontraktorit	Detyrimi i kontraktorit mund t'i transferohet me miratimin e Komuna e Paskuqanit /MASH	Inxhinieri mbikqyrës i punimeve, MASH
Derdhjet aksidentale në ujë dhe tokë	Nëse do të ketë nevojë për instalimin e depozitave për karburantet, ato do të kenë depozita dytësore me volum të mjaftueshëm për të mbajtur një derdhje, ose 110% të depozitës më të madhe, ose do të instalohen depozita me shtresë së dyfishtë. Sheshi do të ketë masa të përshtatshme për kontrollin e erozionit dhe sedimenteve, siç janë dengjet e kashtës dhe rrethimet me baltë për të parandaluar lëvizjen e sedimenteve dhe shkaktimin e turbullirave të tepërta në kanalet e afërta.	Gjatë gjithë periudhës së ndërtimit	Detyrimi i kontraktorit mund t'i transferohet me miratimin e Komuna e Paskuqanit/MASH	Kontraktori	Inxhinieri mbikqyrës i punimeve, MASH, Inspektorët e ARM,
Administrimi i materialeve toksike	Të gjithë materialet duhet të trajtohen në përputhje me udhëzimet e përfshira në Material Safety Data Sheets të pranishme në sheshin e ndërtimit. këto mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm me hollës të bojrave, verniqe, tretës, etj.	Gjatë periudhës së ndërtimit	Detyrimi i kontraktorit mund t'i transferohet me miratimin e Komuna e Paskuqanit/MASH	Kontraktori	Inxhinieri mbikqyrës i punimeve, MASH, Inspektorët e ARM,
Degradimi i zbulimeve të rëndësishme historike ose kulturore	Nëse zbulohen gjetje arkeologjike gjatë përgatitjes së sheshit, kontraktori duhet të ndalojë punimet dhe të ndjekë procedurën për njoftimin e organeve të autorizuar.	Gjatë earthëorks	Detyrimi i kontraktorit mund t'i transferohet me miratimin e Komuna e Paskuqanit/MASH	Kontraktori	Inxhinieri mbikqyrës i punimeve, MASH, Inspektorët e ARM,
Shqetësimi i trafikut	Është e rëndësishme që administrimi i trafikut bëhet në përputhje me ligjet lokale me masat e përshtatshme dhe sistemet e sinjalizimit (p.sh., ndriçim i përshtatshëm, tabelat e sigurisë së trafikut, pengesat dhe personat me flamuj) që janë lehtësisht	Gjatë periudhës së ndërtimit on access roads	Part of the kontraktori regular practice	Kontraktori	Inxhinieri mbikqyrës i punimeve, MASH

	të dukshme apo mund të ndiqen lehtë. Kufizimet e shpejtësisë duhet të afishohen qartësisht.				
--	--	--	--	--	--

Tabela 8 Masat Zbutëse Mjedisore për fazën e Funkcionimit

Ndikimi për shkak të:	Masë Zbutëse e Ndikimit	Vendi dhe koha e performancës	Fondet e zbatimit	Personi Përgjegjës	Funksioni i kontrollit nga:
Prodhimi i mbetjeve (mbetjet komunale dhe kimikatet nga laboratorët)	Shenja të veçanta dhe udhëzime për trajtimin e mbetjeve duhet të afishohen qartësisht në laboratorin e kimisë dhe afër lavamanëve. Derdhja e kimikateve në lavaman është rreptësisht e ndaluar si dhe përzierja e kimikateve. Një kontejner e veçantë për mbetjet kimike duhet të identifikohet dhe shënohet qartësisht. Në laborator duhet të ketë kontejnerë të veçantë për derdhjet. Llojet e ndryshme të mbetjeve duhet të ndahen dhe të ruhen në kontejnerë të përshtatshëm në shkollë. Mbetjet e rrezikshme priten në sasi të vogla dhe duhet të ndahen nga mbetjet e ngurta. Mbetjet duhet të grumbullohen nga grumbullues të licencuar. Regjistrat e largimit të mbetjeve do të mbahen si provë e mirë-administrimit.	Gjatë periudhës së funksionimit	Fonde për mirëmbajtjen rregullt, duhet të përballohen nga shkolla	Mirëmbajtja e shkollës e Mësuesit shkencave	MASH, Inspektorët e ARM
Administrimi i materialeve rrezikshme	Të gjithë materialet duhet të trajtohen në përputhje me udhëzimet e përfshira në Material Safety Data Sheets të pranishme në laboratore. Udhëzimet duhet të shkruhen dhe afishohen qartë në laboratorët e kimisë dhe afër lavamanëve.	Gjatë funksionimit	Fonde për mirëmbajtjen rregullt, duhet të përballohen nga shkolla	Mësuesi laboratorit të kimisë	MASH, Inspektorët e ARM
Përmbytjet mundshme të lumit të Tiranës	Shkolla duhet të përgatisë Planin e Menaxhimit të Emergjencave dhe të bëjë trajnime dhe ushtrime të rregullta për të.	Gjatë funksionimit	Fonde për mirëmbajtjen rregullt, duhet të	Drejtuesi i shkollës	MASH

			përballohen nga shkolla		
Sistemi i ngrohjes ose magazinimi i mazutit apo naftës për gjeneratorët e emergjencës	Duhet të zbatohen masa të mbrojtjes kundër zjarrit. Plani Operativ i Emergjencave duhet të përgatitet nëse magazinimi i karburanteve tejkalon volumnin e 5.000 kg (naftë) dhe / ose 500 kg gaz	Kostoja e përfshirë në funksionimin e shkollës	Minor cost Kostoja e përfshirë në funksionimin e shkollës	Mirëmbajtja e shkollës	MASH, Inspektorët e ARM

Tabela 9 Plani i Monitorimit Mjedisor

Faza	Cili parametër do të monitorohet?	Ku do të monitorohet parametri?	Si do të monitorohet parametri?/lloji i pajisjes monitoruese	Kur do të monitorohet parametri? (në çfarë intervalesh apo vazhdimisht)	Fondet e kërkuara /Kostoja/	Organizata përgjegjëse për Monitorimin
<i>Para ndërtimit</i>	Organizimi i sheshit	Në vendndodhje	Duke kontrolluar rrethimin e duhur, instalimin e objekteve të përkohshme sanitare	Përpara fillimit të punimeve të ndërtimit	Kontraktori përballon kostot e plota, zakonisht nuk identifikohet si kategori e veçantë	Inxhinieri i mbikqyrjes së punimeve Komuna e Paskuqanit MASH Ministria e Mjedisit (inspektimi)
<i>Ndërtimi</i>	Cilësia e ajrit (pluhuri)	Në vendndodhje	Vëzhgim pamor	Vazhdimisht, megjithatë vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet gjatë gjetjes së materialeve dhe punimeve gërmuese	Kontraktori përballon kostot e plota, zakonisht nuk identifikohet si kategori e veçantë	Inxhinieri i mbikqyrjes së punimeve Komuna e Paskuqanit MASH Ministria e Mjedisit (inspektimi)

<i>Ndërtimi</i>	Burimet e materialeve të ndërtimit (asfalt, gurore, rëra/çakulli)	Në vendndodhje	Kontrolli që guroret, etj. kanë një leje të vlefshme operimi Kopjet duhet të mbahen në vendin e punimeve	Në fillim të kontratës	Kontraktori	Inxhinieri i mbikqyrjes së punimeve Komuna e Paskuqanit MASH Ministria e Mjedisit (inspektimi)
<i>Ndërtimi</i>	Zhurmat	Në vendndodhje dhe përreth	Detektor i nivelit të zhurmave	Në javën e parë të ndërtimit dhe pas çdo ankese nga popullata lokale	800 Euro / matje Kontraktori duhet të mbulojë kostot	Inxhinieri i mbikqyrjes së punimeve Komuna e Paskuqanit MASH Ministria e Mjedisit (inspektimi)
<i>Ndërtimi</i>	Ndotje e ujit dhe dheut si pasojë e magazinimit dhe administrimit të papërshtatshëm të derdhjeve dhe përdorimit të materialeve	Në sheshin e ndërtimit	Vëzhgim pamor	Vazhdimisht (në bazë ditore)	Pjesë e kontratës së inxhinierit mbikqyrës Kontraktori	Inxhinieri i mbikqyrjes së punimeve Komuna e Paskuqanit MASH Ministria e Mjedisit (inspektimi)

<i>Ndërtimi</i>	Prodhimi i mbetjeve	Në sheshin e ndërtimit	Dokumentacion shoqëruar i mbetjeve i cili i dorëzohet Ministrisë së Mjedisit në të cilin identifikohen lloji dhe sasitë e mbetjeve	I vazhdueshëm gjatë ndërtimit, d.m.th. sa herë që mbetjet largohen nga vendi i punimeve	Pjesë e kontratës së inxhinierit mbikqyrës gjatë ndërtimit Kontraktori	Inxhinieri i mbikqyrjes së punimeve Komuna e Paskuqanit MASH Ministria e Mjedisit (inspektimi)
<i>Ndërtimi</i>	Zbulime të rastësishme	Në vendndodhje	Mbikqyrje e plotë nga inxhinieri i punimeve gjatë gërmimeve	Gjatë punimeve të gërmimit për themelet	Pjesë e kontratës së inxhinierit mbikqyrës dhe kostove të kontraktorit Kontraktori	Inxhinieri i mbikqyrjes së punimeve Komuna e Paskuqanit MASH Ministria e Mjedisit (inspektimi)
<i>Ndërtimi</i>	Materiale toksike / të rrezikshme	Në vendndodhje	Trajtimi dhe magazinimi i duhur kontrollohet në përputhje me MSDS	Vazhdimisht (në bazë mujore, dhe në bazë të vizitave të rastësishme)	Pjesë e kostove të rregullta të kontraktorit	Inxhinieri i mbikqyrjes së punimeve Komuna e Paskuqanit MASH Ministria e Mjedisit (inspektimi)

<i>Ndërtimi</i>	Siguria e punonjësve	Në vendndodhje, checking eather protective gear, safety helmets, safety belts, ear protection ehen needed is eorn, checking the fencing and earning signs.	Vëzhgim pamor	Continuously (daily) checking that appropriate protective equipment is used	Pjesë e kostove të rregullta të kontraktorit	Inxhinieri i mbikqyrjes së punimeve Komuna e Paskuqanit MASH Ministria e Mjedisit (inspektimi)
<i>Ndërtimi</i>	Rrezik për trafikun publik dhe sigurinë e këmbësorëve	Në vendndodhje dhe në rrugët e lejuara për të hyrë në sheshin e punimeve	Vëzhgim pamor dhe ankesat e mundshme nga publiku	Kontroll i përditshëm i tabelave, rrethimeve, hyrjeve dhe sinjalizimit të trafikut	Pjesë e kostove të rregullta të kontraktorit	Inxhinieri i mbikqyrjes së punimeve Komuna e Paskuqanit MASH Ministria e Mjedisit (inspektimi)
<i>Funksioni</i>	Administrimi i materialeve toksike / të rrezikshme	Në laboratorët e shkollët	Menaxhimi dhe ruajtja e përshtatshme kontrollohet në bazë të ISDS	Vazhdimisht (në bazë javore)	Pjesë e kostove të funksionimit	Mësuesi i laboratorit dhe inspektori i sigurisë në punë, MASH
<i>Funksionimi</i>	Administrimi i mbetjeve (mbetjet komunale dhe kimikatet e laboratorëve)	Në shkollë dhe oborr	Dokumentacion shoqërues i mbetjeve i cili i dorëzohet Ministrisë së Mjedisit në të cilin identifikohen lloji dhe sasi të e mbetjeve	Vazhdimisht gjatë funksionimit	Pjesë e kostove të rregullta të funksionimit	Ministria e Mjedisit (inspektimi), MASH

8 FORCIMI I CAPACITETIT INSTITUCIONAL

Minsitria e Arsimit dhe Shkencës nuk ka përvojë në administrimin mjedisor. Për këtë arsye do të përcaktohet një ndarje e qartë e përgjegjësi dhe detyrave brenda Ministrisë dhe do të kontraktohen konsulentë mjedisorë për të lehtësuar administrimin mjedisor. Sekretari i Përgjithshëm i MASH do të jetë përgjegjës për bashkërendimin dhe monitorimin e veprimtarive në nivel teknik, përfshirë planifikimin dhe administrimin mjedisor. Konsulenti duhet të ketë përvojë të rëndësishme në procesin e VNM dhe duhet të flasë rrjedhshëm gjuhën angleze. Drejtorët e departamenteve përkatëse në MASH dhe drejtuesit e instituteve do të jenë përgjegjës për zbatimin e veprimtarive. MASH do të jetë përgjegjëse për marrjen në punë dhe mbikqyrjen e arkitektëve, inxhinierëve dhe kontraktorëve të kërkuar. Në kontekstin e rehabilitimit, zgjerimit dhe ndërtimit të shkollave, roli i MASH është të administrojë projektimin, tenderimin, mbikqyrjen e projekteve (përfshirë ndërtimin, mallrat dhe shërbimet).

Përgjegjësia e MASH përfshin veprimtaritë e mëposhtme:

- kontraktimi i konsulentit mjedisor i cili do të përgatisë dokumentat e due diligence mjedisore për sheshet individuale në bashkërendim me MASH dhe komunat dhe, gjatë fazës së zbatimit të projektit, do të mbikqyrë zbatimin e PAM dhe do të raportojë mbi ta (komuna do të kontraktojë inxhinierin e saj mbikqyrës që do të jetë në sheshin specifik gjithë kohën gjatë ndërtimit),
- mbikqyrja e punës së kryer nga konsulenti mjedisor, firmat inxhinierike/projektuese, për tu siguruar që ata zbatojnë standartet e duhura dhe po ndjekin procedurat e miratuara, si dhe planin mjedisor të miratuar;
- organizimi i procedurave të tenderit, shqyrtimi i vlerësimit të tenderit të kryer nga firmat e arkitekturës/ndërtimit, dhe sigurimi që kontratat nënshkruhen në pajtim me procedurat e miratuara;
- sigurimi që konsulenti mjedisor po bën një mbikqyrje të duhur të sheshit, veçanërisht mbikqyrjen e zbatimit të planit të administrimit mjedisor.
- Krijimi i një ekipi për çështjet e ndërtimit dhe ato mjedisore në Drejtorinë e Planifikimit Buxhetit MASH.

Ministria nuk ka një njësi të ndarë mjedisore. Për shkak se zbatimi i EEE-P do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis nëpërmjet rehabilitimit, zgjerimit dhe ndërtimit të shkollave, një ekip në Drejtorinë e Planifikimit të Buxhetit do të jetë përgjegjës për bashkërendimin dhe mbikqyrjen e planeve mjedisore dhe masave të zbutjes së rreziqeve të ndërmarra në Projekt dhe për bashkëpunimin me drejtoritë territoriale për mbrojtjen e mjedisit. Për të kompensuar mungesën e kapacitetit brenda Ministrisë, do të kontraktohet një konsulent mjedisor nga Ministria, i cili do t'i raportojë drejtpërdrejt ekipit në Drejtorinë e Planifikimit të Buxhetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë mbi zbatimin e PAM. Banka Botërore do të japë miratimin e termave të referencës për konsulentin mjedisor. Konsulenti mjedisor do të ketë përvojë të mjaftueshme në procesin e VNM dhe duhet të jetë i rrjedhshëm në gjuhën angleze. Konsulenti mjedisor do të merret në punë me kohë të plotë gjatë kohëzgjatjes së programit dhe do të jetë përgjegjës për përgatitjen e PAM dhe mbikqyrjen e zbatimit të tyre, duke i raportuar MASH dhe BB. Ai gjithashtu do të jetë i përfshirë në training . Në

raportin e parë të progresit të zbatimit të projektit një ekip në Drejtorinë e Planifikimit të Buxhetit, me këshillimin dhe të konsulentit mjedisor, do të propozojë një program trajnimi për ekipin e personelit teknik në Drejtorinë e Planifikimit të Buxhetit, anëtarët e bashkive që do të mbikëqyrin punën, inxhinierët mbikëqyrës dhe të sheshit. Ekipi në Drejtorinë e Planifikimit të Buxhetit do të punojë në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse e cila do të ketë detyrën për të realizuar aspektet e prokurimit dhe ato ligjore të projektit dhe Sekretari i Përgjithshëm do të jetë përgjegjës për koordinimin e programit. Ekipi, me mbështetjen e konsulentit mjedisor:

- do të bashkërendojë trajnimin mjedisor për personelin, projektuesit dhe kontraktorët lokalë;
- do të përhapë udhëzimet ekzistuese të administrimit mjedisor dhe do të hartojë udhëzimet në lidhje me çështjet që nuk mbulohen nga rregulloret ekzistuese, për zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e masave zbutëse;
- do të sigurojë kontraktimin për ndërtimin dhe furnizimin me pajisje, përfshirë referimin tek udhëzimet dhe standartet e duhura;
- do të bashkërendojë shqyrtimin mjedisor për nën-projektet;
- do të ndihmojë në organizimin e konsultimeve me publikun për VM/PAM;
- do të kryejë vizita periodike në shesh për të inspektuar dhe miratuar planet dhe për të monitoruar përputhshmërinë me PAM.
- Do të përgatisë raportet e veta dhe do të konsolidojë raportet e marra nga bashkitë dhe komunat dhe inxhinierët e mbikëqyrjes së sheshit rreth zbatimit të PAM.

Komunat dhe Bashkitë do të jenë përgjegjëse për mbikëqyrjen e ndërtimeve për të siguruar, ndërmjet të tjerave, pajtueshmëri të plotë me udhëzimet mjedisore të përfshira në këtë MOP dhe në PAM individuale.

Bashkitë/komunat ku do të ndërtohen shkollat e reja do të jenë përgjegjëse për prokurimin dhe mbikëqyrjen e të gjithë punimeve përkatëse. Bashkitë/komunat do të jenë përgjegjëse për:

- prokurimin e punimeve të lidhura me ndërtimin e shkollave të reja të financuara në kuadër të EEE-P si dhe inxhinierit që mbikëqyr sheshin;
- sigurimin që masat dhe monitorimi në Vlerësimet Mjedisore/PAM individuale të bëhen pjesë e marrëveshjes me kontraktorin inxhinierin që mbikëqyr sheshin; dhe
- mbikëqyrjen e ndërtimeve për të siguruar, ndërmjet të tjerave, pajtueshmëri të plotë me udhëzimet mjedisore të përfshira në këtë MOP dhe PAM individuale.

Pas finalizimit të ndërtimit, përgjegjësia kryesore e monitorimit do të bjerë mbi personelin e Shkollës së Paskuqanit, veçanërisht mësuesit e laboratorëve shkencorë, të cilët do të jenë përgjegjës për administrimin e mbetjeve që prodhohen në laboratore dhe personeli i mirëmbajtjes së shkollës përgjegjës për administrimin e mbetjeve komunale.

Përveç strukturës së Ministrisë së Arsimit dhe Bashkive/komunave, Ministria e Mjedisit, me njësinë e saj të inspektimit mund të marrë pjesë në mbikëqyrjen e zbatimit të nën-projekteve individuale.

Kontrolli i gjendjes së mjedisit është detyra e Inspektoratit të Mjedisit, i caktuar nga Ministri i Mjedisit, dhe Agjencitë Rajonale Mjedisore.

Inspektorati i Mjedisit, herë pas here, viziton sheshin e projektit dhe kontrollon nëse veprimtaritë e kryera janë në përputhje me legjislacionin mjedisor. Inspektorati ka autoritetin të mbyllë, pezullojë, apo të ndalojë pjesërisht ose plotësisht veprimtarinë e personave fizikë dhe juridikë, të cilët kanë shkaktuar ndotje ose dëmtim mjedisor dhe përcakton detyrat përkatëse për përmirësimin e gjendjes. Përshkrimi i detyrave të organeve shtetërore që lidhen me kontrollin mjedisor, është përshkruar në Shtojcën 1.

Zbatimi i dispozitave të PAM do të raportohet rregullisht në raportet progresive gjashtë mujore. Raporti do të marrë mendimin e inxhinierit që mbikëqyr sheshin, konsulentit që mbikëqyr zbatimin e projektit, bashkisë dhe koordinatorit mjedisor në Ministri.

Tabela 10 Përgjegjësitë për mjedisin gjatë ndërtimit dhe funksionimit

<i>Përgjegjësitë për lehtësim dhe monitorim</i>	<i>Rrjedha e informacionit mjedisor (raportim)</i>	<i>Zinxhiri i vendim-marrjes për administrimin mjedisor (për të marrë veprime, për të autorizuar shpenzimet, për ta mbyllur, etj.)</i>	
		<i>Veprimtaritë</i>	<i>Përgjegjësia Institucioni ose personi</i>
<i>Gjatë Ndërtimit:</i>			
Specialist Mjedisor pranë MASH Komuna e Paskuqanit Kontraktuesi	Nga Inxhinieri Mbikqyrës i Sheshit tek konsulentët e MASH / Nga kordinatori mjedisor i MASH tek Sekretari i Përgjithshëm i MASH Inspektorati Mjedisor i Agjencisë Rajonale Mjedisore	Monitorimi i Zbatimit të PAM dhe dispozitave të VM	Inxhinieri Mbikqyrës i Sheshit, Inspektorati Mjedisor i Agjencisë Rajonale Mjedisore
<i>Gjatë Funksionimit:</i>			
Specialist Mjedisor pranë MASH Komuna e Paskuqanit Shkolla e Paskuqanit	Nga Shkolla e Paskuqanit / Komuna e Paskuqanit tek kordinatori mjedisor i MASH tek Sekretari i Përgjithshëm i MASH	Monitorimi i Zbatimit të PAM dhe dispozitave të VM	Personi i caktuar për mirëmbajtjen e shkollës Inspektorati Mjedisor i Agjencisë Rajonale Mjedisore

9 PJESËMARRJA E PUBLIKUT

Pjesëmarrja e publikut për Projektin e Cilësisë dhe Barazisë në Arsim do të ndjekë procedurat e bankës Botërore.

Sipas politikës së Bankës Botërore mbi Vlerësimin e Mjedisit, për të gjithë projektet e Kategorisë B të propozuara për financim nga IDA, gjatë procesit të Vlerësimit Mjedisor, huamarrësi konsulton grupet që preken nga projekti dhe organizatat vendore jo-qeveritare (OJQ) rreth aspekteve mjedisore të projektit dhe merra në konsideratë këndvështrimet e tyre të paktën një herë. Huamarrësi i fillon këto konsultime sa më herët të jetë e mundur. Gjithashtu, huamarrësi konsultohet me këto grupe përgjatë gjithë zbatimit të projektit sipas nevojave, për të trajtuar çështjet e lidhura me VM të cilat i prekin ata.

Projekti dhe raporti i vlerësimit të ndikimit mbi mjedisin duhet t'i nënshtrohen konsultimit me publikun. Konsultimi duhet të organizohet nga qeverisja vendore në zonën ku projekti do të zbatohet dhe propozuesi. Qeverisja vendore do të ftojë grupet e interesit, do të verë në dispozicion raportin e VM, do të vendosë rreth datës për debat dhe do të njoftojë pjesëmarrësit për ditën, orën dhe vendin e takimit. VM duhet të jetë i disponueshëm për të gjithë grupet e interesit tre javë përpara prezantimit.

Propozuesi i nën projektit, bashkia, informon publikun rreth: a) Vendndodhjen ku do të zbatohet projekti; b) Lloji i veprimtarisë; ; c) nëse është e mundur lëndën e parë, energjinë, ujën që do të përdoret; d) Kohëzgjatjen e projektit; e) Mbetjet që do të prodhohen, lloji dhe sasia nëse është e mundur; f) Ndikimi negativ mbi shëndetin dhe mjedisin (shkarkimet në ujë, ajër dhe tokë) g) Masat që do të merren për reduktimin e ndikimeve të mundshme.

Propozuesi do të trajtojë të gjithë pyetjet e ngritura dhe këtij dokumenti do t'i bashkëngjiten shënimet e mbledhjes. Vetëm atëherë VNM-ja mund të konsiderohet përfundimtare.

10 SHTOJCAT

10.1 SHTOJCA 1 ROLET DHE PËRGJEGJËSITË E ORGANEVE SHTETËRORE NË LIDHJE ME MJEDISIN

Rrjeti institucional mjedisor

Të gjithë organet e specializuara, që sipas ligjit janë të ngarkuara me mbrojtjen e mjedisit në Republikën e Shqipërisë, përfaqësojnë kuadrin institucional mjedisor të vendit.

Kuadri institucional mjedisor përfshin Ministrinë e Mjedisit, Agjencitë Rajonale Mjedisore (ARM), Inspektoratin Mjedisor, organet mjedisore në varësi të autoriteteve kryesore qendrore dhe lokale, si dhe organizmat ndër-ministorë, të miratuar nga Këshilli i Ministrave për të ndjekur çështje të rëndësishme mjedisore.

Organet e pushtetit qendror dhe lokal, si administratorë legjitimë të elementeve të ndryshëm mjedisorë, realizojnë mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet zbatimit të këtij funksioni.

Ministria e Mjedisit

Si një institucion i specializuar në mbrojtjen e mjedisit dhe një organ teknik mbështetës i Ministrisë së Mjedisit, Ministria e Mjedisit kryen këto detyra kryesore:

- Bashkëpunon dhe bashkërendon me institucionet qeveritare qendrore dhe lokale, me publikun dhe me organizatat jo-fitimprurëse, për të rritur nivelin e zbatimit të legjislacionit mjedisor.
- Përgatit projekt marrëveshjet, protokollet, projektet dhe programet dypalëshe ose shumëpalëshe në bashkëpunim me qeveritë, me organet dhe organizatat ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit dhe ndjek zbatimin e tyre.
- Studjon nevojat e vendit për specialistë dhe bashkërendon veprimtaritë e kualifikimit dhe specializimit të personelit që trajton mbrojtjen mjedisore, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.
- Mbështet projektet rreth kërkimit shkencor, futjes së teknologjive ekologjikisht të pastra dhe nxitjen e veprimtarive të organizatave jo-fitimprurëse.
- Ndihmon organet e qeverisë vendore për mbrojtjen e mjedisit dhe përgatitjen e planeve lokale mjedisore të veprimit.

Agjencitë Rajonale Mjedisore

Agjencitë Rajonale Mjedisore (ARM) janë organe të specializuara në mbrojtjen e mjedisit, në varësi të Ministrisë së Mjedisit dhe të cilat funksionojnë në nivel prefecture. Ndërkohë që zbatojnë objektivat dhe përparësitë e Ministrisë së Mjedisit, ARM-të:

- Kryejnë zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit në nivel vendor;
- Ndihmojnë organet e qeverisjes vendore në fushën e mbrojtjes dhe administrimit të mjedisit në juridiksionin e tyre; bashkëpunojnë me qeverinë vendore për zhvillimin e planeve, programeve dhe projekteve;
- Promovimi i teknologjive të pastra dhe futja e sistemeve të administrimit mjedisor;

- Janë të përfshira ne procesin e miratimit të lejes dhe deklaratës mjedisore, duke kryer detyrat e përcaktuara nga Ministri i Mjedisit në një rregullore të veçantë. Ata lëshojnë pëlqimet dhe autorizimet mjedisore për veprimtaritë vendore.
- Ndërmarrin veprimtari ndërgjegjësimi për mbrojtjen e mjedisit dhe bashkëpunojnë me komunitetin, publikun dhe OJQ-të mjedisore dhe organizatat profesionale të biznesit.

Inspektorati Mjedisor

Inspektorati Mjedisor funksionon pranë Ministrisë së Mjedisit, si një organ i specializuar për kontrollin mjedisor. Inspektorati Mjedisor përbëhet nga: Kryeinspektori, inspektorët e Ministrisë së Mjedisit dhe inspektorët e ARM-ve. Inspektorët e Ministrisë së Mjedisit ushtrojnë veprimtarinë e tyre kontrolluese në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, ndërsa inspektorët e ARM-ve funksionojnë në territorin e prefekturës.

Inspektorati Mjedisor:

- Ushtron kontroll të vazhdueshëm mbi mjedisin dhe veprimtaritë ndotëse për të garantuar mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet zbatimit të legjislacionit të mjedisit dhe kushteve të lejes dhe deklaratës mjedisore.
- Kërkon pjesëmarrjen e autoriteteve të qeverisë vendore, të përfaqësuesve të bashkive dhe komunave, të organizatave jo-fitimprurëse mjedisore dhe të mediave gjatë kontrolleve mbi mjedisin.
- Krijon dosjen mjedisore për çdo veprimtari që është e pajisur me një leje mjedisore. Ministri i Mjedisit përcakton rregullat e hollësishme mbi formatin, përmbajtjen dhe administrimin e dosjes mjedisore.
- Ndihmon personat fizikë dhe juridikë për të realizuar vetë-monitorimin, verifikimin dhe zbatimin e sistemeve të integruara të administrimit dhe kontrollon zbatimin e tyre.
- Urdhëron zbatimin e masave detyruese që duhen marrë për përmirësimin e gjendjes së mjedisit, për pakësimin e ndotjes dhe dëmit mjedisor.
- Informon rregullisht autoritetet vendore mbi gjendjen e mjedisit, veprimtaritë, projektet dhe impiantet e miratuara, sipas dispozitave të këtij ligji.
- Kontrollon regjistrin e ndotësve, rregulloret e brendshme, teknike dhe teknologjike dhe dokumentet e tjera të lidhura me veprimtarinë dhe rreziqet e ndotjes.
- Vendos sanksione, sipas këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore që mbrojnë elemente të veçantë të mjedisit.
- Publikon rezultatet e çdo kontrolli të ushtruar.

Mediat publike

Mediat publike ndihmojnë në:

- mbrojtjen e interesave kombëtare në fushën e mbrojtjes së mjedisit;

- shtimin e njohurive dhe kulturës bashkëkohore mbi mjedisin;
- realizimin e të drejtës së publikut për tu informuar mbi gjendjen e mjedisit;
- përhapjen e arritjeve teknike dhe shkencore në fushën e mjedisit dhe të veprimtarive kombëtare në këtë fushë.

Autoritetet e qeverisë vendore

Autoritetet e qeverisë vendore përfaqësojnë strukturën më të rëndësishme qeverisëse për administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit që ata kanë nën juridiksionin e tyre, duke zbatuar përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrat që u janë përcaktuar nga Ligji Nr. 8652, datë 31.07.2000, “Mbi Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore”. Në fushën e mbrojtjes së mjedisit, ato kanë detyrat e mëposhtme:

- realizimin e zbatimit të legjislacionit mjedisor;
- hartimin e planeve vendore për mbrojtjen e mjedisit dhe planeve për rregullimin e territorit;
- publikimin e programeve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit;
- informimin e publikut mbi gjendjen e mjedisit dhe veprimtaritë vendore që janë subjekt i vlerësimit të ndikimit mbi mjedisin;
- promovimin dhe mbështetjen e veprimtarive të organizatave jo-fitimprurëse për mjedisin, duke tërhequr mendimin e tyre mbi procesin e vendim-marrjes mjedisore;
- përcaktimin e vendeve për grumbullimin dhe përpunimin e mbetjeve të prodhimit dhe jetës së njerëzve, në përputhje me kriteret mjedisore dhe planet e zhvillimit;
- organizimi i depozitimit të mbetjeve dhe lëndëve të rrezikshme si dhe mbrojtjen e zonave të gjelbra në qendrat urbane dhe rreth tyre;
- administrimi i mbetjeve urbane, impianteve të trajtimit të ujrave të zeza dhe të mbetjeve të ngurta; dhe
- disiplinimi i transportit dhe ndërtimeve në mjedisin urban.

10.2 SHTOJCA 2 ANALIZA E UJIT TË PIJSHËM

Republika e Shqipërisë
Ministria e Shëndetësisë
Instituti i Shëndetit Publik
Tiranë

Nr. 1094 Prot

Tiranë, më 24.06.09

Raport i Analizës Nr. 74

Lloji i Kampionit: Ujë i pijshëm (pas trajtimit) nga impianti i Bovillës

Enti dorëzues: Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Dërguar me: Kërkesë nr. 656 prot, datë 12.05.2009

Enti marrës i kampionit: Specialistët e Institutit të Shëndetit Publik

Data e marrjes së kampionit: 22.05.2009

Lloji i vlerësimit: Analizë fiziko-kimike, mikrobiologjike dhe toksikologjike

Vlerësimet mikrobiologjike

Nr.	Indeksi mikrobiologjik	Ujë pas trajtimit në impiantin e Bovillës	Normat
1	Coliforme total	0	0/100 ml ujë

2	Coliforme faeces	0	0/100 ml ujë
3	Faece Streptococci	0	0/100 ml ujë

Vlerësimet fiziko-kimike

Nr.	Treguesit kimikë	Uji pas trajtimit të impiantit të Bovillës	Normat	Nivelet e lejuara maksimale
1	Shija dhe era (numri i hollimit)	Normal	0	2 në 12° C në 25°C
2	Ngjyra dhe pamja e jashtme (mg/1 gradë Pl/Co)	Normal	1	20
3	p ^H (njësi p ^H)	7.9	6.5-8.5	9.5
4	Përçueshmëria elektrike (µS/cm)	320	400	
5	Kalcium (mg/l)	45.09	75	200
6	Lëndë pezulli	0	Nuk lejohet	
7	Turbullirë (Njësi FTU)	0	0.4	4
8	Alkalinësitë Total (mg ekv/l)	3.6		
9	Karbonatet (mg/l)	0		
10	Bikarbonatet (siHCO ₃)	219.16	Uji nuk duhet të ketë CaCO ₃	
11	Amoniak (mg/l)	0	0	0.05
12	Nitrat (mg/l)	0	0	0.05
13	Nitrat (mg/l)	0	0	0.05
14	Fortësia totale (° Gjermane)	9.24	10.15	20
15	Fosfat (mg/l)	0.29	0.4	2.5
16	Lëndë organike (mg/l)	0.32	1	3
17	Klorur (mg/l)	28.36	25	200
18	Sulfat (mg/l)	24	25	250
19	TDS (mg/l)	160	500	
20	Plumb total (µg/l)	n.d	50	300
21	Magnezium (mg/l)	12.76	20	50
22	Mangan (µg/l)	n.d	20	50
23	Krom (µg/l)	n.d	20	50
24	Plumb (µg/l)	n.d	0	10
25	Kadmium (µg/l)	n.d	3	5
26	Bakër (µg/l)	n.d	100	1000
27	Nikel (µg/l)	n.d	20	50
28	Mërkur (µg/l)	n.d	0	1
29	Arsenik (µg/l)	n.d	10	50

Rezultatet e analizave të lëndëve Djegëse Hidrike Policiklike Aromatike (PAH)

Nr.	Emërtimi i përbërësit	Uji nga impianti i Bovillës
1	Naftalinë	n.d.
2	Acenaftalinë	n.d.
3	Acenaften	n.d.
4	Fluoren	n.d.
5	Fenantren	n.d.
6	Antracen	n.d.
7	Fluoranten	n.d.
8	Piren	n.d.
9	benzo (b) antracen	n.d.
10	Krizen	n.d.
11	benzo (b) fluoranten	n.d.
12	benzo (k) fluroranten	n.d.
13	benzo (a) pyren	n.d.
14	dibenzo (a,b) antracen	n.d.
15	benzo (g,h, i) perilen	n.d.
16	Indeno (1,2,3 -Cd) piren	n.d.
	Normat 0-0.2 (µg/l)	

REZULTATET E ANALIZËS PËR PESTICIDE KLOROORGANIKE

Nr	Përbërësi	Përqëndrimi (µg/l)
1	α -Heksaklorocikloheksan (α-HCH)	n.d.
2	Heksaklorobenzen (HCB)	n.d.
3	β-Heksaklorocikloheksan (β-HCH)	n.d.
4	γ-Heksaklorocikloheksan (lindan)	n.d.
5	δ-Heksaklorocikloheksan (δ -HCH)	n.d.
6	Heptaklor	n.d.
7	Heptakloroepoksid B	n.d.
8	Kaptan	n.d.
9	O,p'-DDE	n.d.
10	α-Endosulfan	n.d.
11	P,p'-DDE	n.d.
12	Dieldrin	n.d.
13	O,p'-DDE	n.d.
14	Endrin	n.d.
15	β-Endosulfan	n.d.
16	p,p'-DDD	n.d.
17	O,p'-DDT	n.d.
18	p,p'-DDT	n.d.
19	Metoksiklor	n.d.
20	Mireks	n.d.

Përfundimet: Nga analiza e mësipërme mikrobiologjike, fiziko-kimike dhe toksikologjike (metale të rënda, pesticide dhe hidrokarburantet policiklike aromatike) të kampionit të ujit **rezulton që**: Të gjithë parametrat e analizuar janë brenda normave dhe standarteve aktuale në fuqi në Shqipëri për ujin e pijshëm.

Shënim: n.d. – do të thotë nuk diktohet.

Raport: Analiza është e vlefshme vetëm për kampionin e sjellë dhe të analizuar në laborator.

Drejtori

Dr. Alban Ylli

10.3 SHTOJCA 3, ANALIZA E DHEUT

NJË RAPORT MBI GJENDJEN E NDOTJES SË DHEUT NË ZONËN KU DO TË NGRIHET SHKOLLA E PASKUQANIT

Me kërkesë të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, datë 22 Maj 2009, u administrua një kampionim i dheut në zonën e Paskuqanit. Qëllimi i kampionimit ishte të vëzhgohej nga afër prania e ndotjes nga metalet e rënda dhe lëndët radioaktive të zonës ku shkolla është parashikuar të ngrihet.

U morën pesë kampione të dheut (shih fig 1) nga një pjesë toke me përmasat 35 X 35 cm me qëllim që të realizohej një mbulim më i mirë i zonës në studim. Kampionet u ekspozuan ndaj procesit të tharjes, u pastruan nga rrënjët e bimëve apo grimcat e gurëve dhe pastaj u bluan.




Fig. 1: Paraqirja skematike e sheshit ku është realizuar kampionimi

Pas përpunimit fillestar, kampionet, në bazë të mëtejshme specifike, ju nënshtruan analizave për të zbuluar ndonjë ndotje radioactive apo ndotje të tjera që i atribuohen pranisë së metaleve të rënda.

Rezultatet mbi metalet e rënda

Analizat e metaleve të rënda u kryen bazuar në metodën *Fluorescence Radiation X (FRX)*, e cila është një metodë analitike me kufinj të zbulimit të përshtatshëm për pjesën më të madhe të metaleve të rënda.

Rezultatet, të agreguara dhe të paraqitura në tabelën e mëposhtme, tregojnë që nuk takojmë ndonjë lloj ndotjeje nga ndonjë prej elementeve të analizuara. Vlerat e përlogaritura të metaleve dhe veçanërisht të atyre elementeve si **Cr**, **Mn**, dhe **Ni** theksojnë me të drejtë karakteristikat gjeologjike të zonës. Duhet gjithashtu të shtojmë se nëpërmjet aplikimit të metodës FRX është përcaktuar sasia totale e metaleve në kampionet e dheut, duke mos marrë në konsideratë sasi të tretura që mund të hyjnë në ciklin e jetës.

Elementet	Luhatja e përqëndrimeve të matura	Vlerat kufi (Direktiva 86/278 EEC)
Fe (%)	4.5-5.0	-
Cr (mg/kg)	350-400	-
Mn (mg/kg)	770-920	-
Ni(mg/kg)	230-270	30-75
Cu(mg/kg)	30-70	50-140
Zn(mg/kg)	90-115	150-300
Pb(mg/kg)	30-50	50-300
As(mg/kg)	<10	-
Cd(mg/kg)	<5	1-3

Përsa i përket elementeve *As* dhe *Cd* të cilat kishin vlera poshtë kufirit të diktimit nga metoda FRX, kampionet po analizohen nëpërmjet metodës spektrometrike të absorbimit atomik. Këto rezultate do jenë të disponueshëm pas përfundimit të analizës.

Rezultatet mbi ndotjen radioaktive

Në fushën në fjalë ekipi i QFBA (Qendra për Fizikën Bërthamore të Aplikuar) si hap i parë drejt qëllimit final, kreu ushtrimin e rilevimit radioaktiv duke matur në të gjithë pikat në zonë fuqinë e dozës mjedisore. Nga rezultatet e marra është e dukshme që në të gjithë pikat e vëzhguara fuqia e dozës bie poshtë vlerës 100nSV/orë, e cila përfaqëson vlerën mesatare të fuqisë mesatare mjedisore për rajonin.

Hapi i dytë është kryesisht i lidhur me administrimin e matjeve spektrometrike gama të mbledhura nëpërmjet sistemit laboratorik të QFBA. Matjet e tyre paraprake tregojnë praninë e radionuklideve natyrore si ²²⁶Ra, ²³⁸U, ²³⁵U, ²³²Th, ⁴⁰K, ndërsa prania e radionuklidit ¹³⁷Cs, i cili mbahet sin je nga treguesit e ndotjes radioaktive është mjaft poshtë kufijve të zbulimit.

Prania e radionuklideve natyrore me një periudhë relativisht të gjatë gjysëm-zbërthimi, e cila është karakteristikë dhe pasojë përbërjes kimike të dherave në studim, përbën kontributin kryesor të *fonit natyror* (?).

Një analizë mjaft më e detajuar e këtyre ushtrimeve specifike të nuklideve të sipërpërmendura do të kërkonte të paktën 25 ditë dhe, nëse dhe kur është e nevojshme, rezultatet do të jenë të disponueshëm pas përfundimit të analizës.

Si përfundim, ne mund të pohojmë plotësisht që nuk është gjetur ndotje radioaktive në zonë, përveç *fonit natyror* i cili është brenda vlerës që konsiderohet si mjaft normale në rajonin tonë.

Personat përgjegjës për analizën

Dr. Durim Kryeziu

Prof. Asoc. Nikolla Civici

UNIVERSITI I TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE NATYRORE
QENDRA E FIZIKËS BËRTHAMORE TË APLIKUAR

Nr. 1053 Prot.

Tiranë, 28 Shtator 2009

Lënda: Përgjigje ndaj letrës tuaj

Në vëmendje të: Znj. Antoneta LULI
Sekretare e Përgjithshme
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

TIRANË

Në përgjigje të letrës tuaj Nr. 2876/8, datë 24.09.2009, me anë të të cilës kërkonit informacion mbi analizat e dheut në zonën ku do të ngrihet shkolla e Paskuqanit, ju informojmë si më poshtë:

Deklarata që përqëndrimi mjaft i lartë i elementeve si Ni, Cr, Mn në dheun e zonës së referuar ka origjinë natyrore, përveç bazës në përvojën analitike bazohet gjithashtu në mungesën e informacionit mbi burimet e ndotjes në zonë. Megjithatë, ju mund të përdorni për referim Atlasin Gjeografik të Shqipërisë me autorë A. Tashko, A. Mazreku, etj. të publikuar në periudhën 1997-1998. Atlasi përfshin harta të shpërndarjes së elementeve të ndryshëm në dherat dhe sedimente në të gjithë territorin e vendit.

Ne e konsiderojmë si shumë të dobishme që ju të takoheni me Z. Salvatore Bushati, sekretarin shkencor të Akademisë së Shkencave.

Përgjegjës i qendrës
Nikolla CIVICI

Dekani i Fakultetit të Shkencave Natyrore
Ilirjan MALOLLARI

UNIVERSITI I TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE NATYRORE
QENDRA E FIZIKËS BËRTHAMORE TË APLIKUAR

Nr. 1143 Prot.

Tiranë, 14.10.2009

Lënda: Përgjigje ndaj letrës tuaj

Në vëmendje të: Znj.Antoneta LULI
Sekretare e Përgjithshme
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

TIRANË

Në përgjigje të letrës tuaj Nr. 2876/8, datë 24.09.2009, mbi informacionin shtesë rreth analizës së dheut në vendin e ndërtimit të shkollës së paskuqanit, ne po ju dërgojmë disa të dhëna të marra nga inspektimi sensorial i kampioneve të marra për analizë.

1. Të gjithë kampionet u morën në një zonë me bimësi normale. Këto dhera kanë një ngjyrë gri he nuk përmbajnë gurë të vegjël;
2. Kampionet kanë lagështirë të ulët, mund të grimcohen lehtësisht dhe duken që nuk kanë përbërje vajore;
3. Kampionet nuk kanë erën karakteristike që mund t'i bënte ata të dyshuar për ndonjë ndotje me PCB, etj.

Së fundmi, ne mund të pranojmë që inspektimi sensorial nuk jep shenja të ndonjë ndotjeje të mundshme.

Përgjegjësi i qendrës

Nikolla CIVICI

10.4 SHTOJCA 4, CILËSIA E LUMIT TË TIRANËS

RAPORT MBI GJENDJEN MJEDISORE TË LUMIT TË TIRANËS, ZONA E PASKUQANIT, BAZUAR NË RAPORTIN E PROGRAMIT TË MONITORIMIT DUKE PATUR PARASYSH VITIN 2008

Në kontekst të programit të monitorimit të shkarkimeve të ujit të pazakonta për ujrat nëntokësore për vitin 2008, **Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve** ka administruar procesin e monitorimit të ujrave nëntokësore të lumit të Tiranës përgjatë tre stacioneve të monitorimit: *Ura e Brarit, Zona e Paskuqanit* - 500 metra larg nga kolektori i ujrave të Siri Kodra – dhe ura e Kamzës.

Më poshtë ne paraqesim rezultatet e këtij procesi monitorimi.

Zona e Paskuqanit (500 metra larg kolektorit të ujrave në Siri Kodra): Ajo i përket një zone të konsideruar si të ndotur, për shkak të shkarkimeve të kolektorëve të ujrave urbane dhe për shkak të mbetjeve urbane të derdhura në të dy brogjet e lumit. Pika e zgjedhur për të mbledhur kampionet gjendet në një largësi prej 500 – 600 metra nga kolektori kryesor për shkarkimin e ujrave urbane.

[në kopjen origjinale ka një imazh të errët të lumit]

Pamje e lumit të Tiranës në zonën e Paskuqanit pas shkarkimeve të kolektorëve.

Vlerësimi i cilësisë bazuar në treguesit fiziko-kimikë:

Bazuar në rezultatet mesatare të analizës, siç përshkruhet në tabelën e agreguar “Tirana” më poshtë, në bazë të klasifikimit të UNESCO, është bërë vlerësimi i cilësisë së ujit të lumit të Tiranës, duke e futur atë në grupime për veti dhe parametra përkatës.

Stacionet	Klasa P, totali	Klasa N03	Klasa NB05	Klasa NKO	Klasa NH4	Klasa O2
T1: Ura e Brarit	IV	I	II	II	I	II
T2: pas kolektorit të ujrave në Siri Kodra	IV (tejkalon)	I	V (tejkalon)	V (tejkalon)	IV	III
T3: Ura e Kamzës	V (tejkalon)	I	V (tejkalon)	V (tejkalon)	V (tejkalon)	III

Nga tabela e mësipërme është e mundur të dallohet që në zonën e ujit tek Ura e Brarit, ujrat e lumit klasifikohen që i përkasin cilësisë së dytë (nivel i mjaftueshëm) me përjashtim të përmbajtjes së fosforit e cila, duke folur në përgjithësi, siç do të dalë më poshtë, është një tregues që tregon përmbajtjen e lartë të fosforit në ujrat e lumit tonë.

Rezultatet e analizës së nitratis tregojnë vlera të ulëta përgjatë gjithë gjatësisë së lumit në shqyrtim. Një përqëndrim i ulët i nitrateve do të haset dhe në stacionet e tjera siç do të shohim më poshtë.

Duke lëvizur nga lumi i *Brarit* (stacioni 1) drejt urës së *Kamzës* (stacioni 3), lumi i Tiranës është pika marrëse e shkarkimeve të popullatës që është vendosur përgjatë brigjeve të lumit në dhjetëvjeçarin e fundit si dhe të shkarkimeve urbane që vijnë nga kolektorët e shkarkimit në rrugët “*Siri Kodra*” dhe “*5 Maji*” street. Këto shkarkime mund të konsiderohen si fajtorët kryesorë për vlerat e larta të fosforit i cili i atribuohet kryesisht përdorimit të detergjentëve me përmbajtje të lartë fosfori nga ana e popullatës si dhe përmbajtjet e lartë e lëndës organike e cila shprehet në vlerat e larta të NBO, NKO dhe NH4.

Gjatë leximit të tabelës së klasifikimit, përveç stacionit të parë të monitorimit, ura e *Brarit*, dy stacionet e tjera shfaqin një prani alarmuese të lëndës organike në ujrat e lumit të Tiranës.

Si përfundim, ne mund të deklarojmë plotësisht që përqëndrimet e larta të lëndës ushqyese (fosfor) dhe pranisë së lartë të lëndës organike paraqesin një gjendje serioze të procesit të *eutrofikimit* dhe balancës së oksigjenit në ujë për popullatat e peshkut në këto ujra. Gjendja mund të lidhet gjithashtu me mbetjet e lëngshme urbane, të cilat nuk trajtohen, të shkarkuara në këto ujra. Masat drejt përmirësimit të gjendjes do të duhet të jenë të rrepta dhe të shumëfishta në natyrë.

Treguesit bakteriologjikë

Stacionet	Coliform feces (mesatare)	Normat detyruese (BE)	Klasifikimi
T1: Ura e Brarit	1.4 X 10 ⁵	2000	Tejkalim norme
T2: Pas kolektorit të Siri Kodrës	9.6 X 10 ⁶	2000	Tejkalim norme
T3: Ura e Kamzës	3.1 X 10 ⁷	2000	Tejkalim norme

Duke krahasuar dhe ballafaquar treguesit bakteriologjikë të analizës, dhe veçanërisht *feces coliform*, përkundrejt normave detyruese të vendosura nga Direktiva e BE mbi ujrat larëse, ne vëmë re që në të tre stacionet përgjatë lumit të Tiranës të monitoruara, vlera qëndron shumë më lart se në normat e lejueshme.

Ky vlerësim kërkon një ndalim të menjëhershëm të përdorimit të ujit të lumit të Tiranës për qëllime larjeje apo veprimtari të tjera shlodhëse, të paktën përgjatë të gjatësisë së lumit në studim.

ëb313516

C:\Documents and Settings\ëb313516\My Documents\Albania - Education\VM_Paskuqan_school_Oct_6.doc

10/07/2008 11:21:00 PM